



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER
JANAR 2006, NO 20

A photograph of a group of men in suits sitting around a large, dark wooden conference table. They appear to be in a formal meeting or negotiation. The room has large windows with curtains in the background. The text is overlaid on the lower half of the image.

Fillojnë negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës

Editorial



Ky numër i Buletinit Informativ të ASI-it i kushtohet fillimit të procesit për përcaktimin e statusit të Kosovës, rolit të Kuvendit të Kosovës dhe avansimit të shkathtësive negociuese.

Pas vlerësimit të standardeve dhe shqyrtimit gjithëpërfshirës të situatës në Kosovës nga ana e Ambasadorit Kai Aide në shtator 2005, Kosova hyri në fazën historike të saj. Me 24 tetor 2005 Këshilli i Sigurimit të KB-ve mbështeti propozimin për të nisur bisedimet për statusin final të Kosovës. Ish- Presidenti i Finlandës Mati Ahtisari është emëruar si i Dërguar Special për bisedimet rreth statusit. Ndërsa, Grupi i Kontaktit i ka nxjerrë dhjetë parime udhëzuese për përcaktimin e statusit. Me 22 nëntor z. Ahtisari tok me zëvendësin e tij Albert Rohan arriti në Kosovë për t'u takuar për herë të parë me delegacionin e Kosovës.

Gjatë javëve të shkuara Delegacioni i Kosovës u takua disa herë për t'i themeluar strukturat, të cilave u është besuar që të dalin me propozime dhe opione politike për bisedat. Ndërkaq, me 17 nëntor Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë, ku janë përvijuar parimet të cilat mëton t'i realizojë me rastin e marrjes së vendimit për status nga ana e Këshillit të Sigurimit të KB-ve.

Krahas aktiviteteve politike dhe diplomatike rreth statusit, do të ketë nevojë edhe për punë intensive parapërgatitore, zhvillim të strategjive dhe thellim të shkathtësive negociuese. Kështu që, prej datës 30 tetor deri me 30 nëntor, shqiptarët dhe serbët e Kosovës kanë punuar në mënyrë intensive rreth avansimit të shkathtësive të tyre negociuese. Me këtë rast, deputetët e Kuvendit, ekspertët e qeverisë dhe përfaqësuesit e partive politike morrën pjesë në një mori ngjarjesh, të organizuara nga Shkolla Filleçer për Drejtësi dhe Diplomaci, Grupi për Ligjin Publik Ndërkombëtar dhe Politikë dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Në këtë numër të Buletinit Informativ të ASI-it mund të lexoni materiale rreth procesit diplomatik dhe politik të negociatave, rolin e Kuvendit të Kosovës si dhe për përvojat nga programi mbështetës për përgatitjen për negociata. Kështu, në këtë edicion janë përfshirë një mori dokumentesh dhe opinionesh, që reflektojnë mendime të ndryshme rreth procesit. Mbetemi me shpresë se do t'ju duken interesante dhe i mirëpresim reagimet tuaja.

Franklin De Vrieze,
Kordinator i Iniciativës për Përkrahje Kuvendit (ASI).

3. Kosova si çështje evropiane

Veton Surroi

4. Kuvendi dhe bisedimet

Ramush Tahiri

5. Kohë vendimtare për Kosovën

Mark Dickinson

6. Fjala hyrëse e ambasadorit Verner Vnent me rastin e fillimit të programit për zhvillimin e shkathtësive për negociim

8. Paradigma e ndryshimit: Thelbi i ndryshimit të suksesshëm

Roelf Meyer

10. Përmirësimi i shkathtësive negociuese përmes simulimit, hartimi i ligjeve

Paul Williams

11. Shkolla e Filleçerit për Drejtësi dhe Diplomaci ofron trajnime për negociata për liderët serbë dhe shqiptarë në Kosovë

Eileen Babbitt

12. "Serbët nuk janë vetëm pjesë e problemit, ata janë edhe pjesë e zgjidhjes"

Biserka Ivanoviq

13. Synonim kthimin e dokumentacionit dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Kosovës

Astrit Haraqija

14. Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës

16. Vendimi i Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të Unionit Evropian për Kosovën

17. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës

18. Dokumenti i Delegacionit të Kosovës për Marti Ahtisarin, Emisarin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për statusin final të Kosovës

20. Negociatat kundër vetëvendosjes

Albin Kurti

22. Zhvillimet e fundit në Kuvend

Franklin De Vrieze



Në tetor 2005, për dy ditë me radhë, 24 ambasadorë të OSBE-së morën pjesë në takimet e shkurta informative dhe në mbledhjet për vlerësimin e gjendjes në Kosovë, para fillimit të bisedimeve për status. Delegacioni u takua me liderët politik të të gjitha komuniteteve në Kosovës dhe me krerët e disa organizatave ndërkombëtare.

Kosova si çështje evropiane

Veton Surroi, anëtar i Kuvendit të Kosovës, Grupit Negociator të Kosovës dhe kryesues i Këshillit Konsultativ për Komunitete Pakicë në kuadër të Grupit Negociator

Çështja e Kosovës mund të jetë simboli i politikës së re të jashtme të Evropës, gjegjësisht, fitorja e parë e asaj që mund të jetë në të ardhmën Ministria e jashtme e Bashkimit Evropian.

Sivjet, me një ko incidencë zhvillimesh, Bashkimi Evropian kapasur disa simbolet e rrjedhëve të së ardhmës. Referendumet në Francë dhe Holandë për Kushtetutën Evropiane treguan animozitet ndaj zgjerimit më të shpejtuar të tij. Në këtë kushtetutë që paraparë edhe formimi i Ministrisë së jashtme evropiane, e cila do të merrte përsipër më shumë obligime në emër të përbashkët të 25 vendeve evropiane.

Hiç më larg se disa muaj më vonë, Evropa e Bashkuar morri, me një mandat të Kombeve të Bashkuara dhe me përkrahje të drejtpërdrejtë amerikane dhe ruse, pothuajse rolin kyç të ndërmjetësimit për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës.

Më 1998-1999, Kosova shërbeu si mostër e vazhduar, pas Kroacisë dhe Bosnjes, se për të zgjidhur probleme në Evropë ende është i nevojshëm roli prijës amerikan. Më 2005, me përcaktim të përbashkët evropian-amerikan, është saktësuar se Kosova është vendi i cili i bashkon interesat strategjike amerikane, për të mos u marrë më me disa prej problemeve "të vogla" siç është Kosova dhe atyre evropiane që të merret më shumë përgjegjësi për problemet e kontinentit. Natyrisht, e tëra kjo me një iniciativë diplomatike të shprehur amerikane që solli thyerjen e statusit quosë ekzistuese në trajtimin e çështjes së Kosovës.

Kalimi themeltar nga një cilësi



politike në tjetrën do të bëhet i qartë për evropianët që tani. Deri më sot, politika e BE-së për Kosovën ka mundur të përcaktohet, ndonëse në formë të vrazhdtë, si siguri i fondeve për një mision të OKB-së. Kjo do të thotë se burokratët e OKB-së kanë shpenzuar paratë të cilat në masë të madhe i ka siguruar BE-ja. Paradoksi ka qenë se, ndonëse, BE-ja nuk ka mbajtur përgjegjësi për to, por është trajtuar si përgjegjëse para opinionit publik. Shembull eklatant janë paratë e shpenzuara në KEK; vendimi për shpenzimin e mbi gjysmë miliardë euro ka qenë politik, nga UNMIK-u, paratë kanë qenë të BE-së, e për popullatën e cila pas gjashtë vjetësh ende kupton se nuk ka rrymë të mjaftueshme, gishti i përgjegjësisë drejtohet kah BE-ja.

Në fakt, BE-ja nuk di të menaxhojë vende të tjera, dhe këtë as që e ka bërë. (Do të thënë, as OKB-ja nuk është dëshmuar

se di të menaxhojë, por ky është rrëfim tjetër). Fuqia e BE-së, gjatë dekadave të kaluara, ka qenë transformimi i shoqërive nëpërmjet joshjes, jo diktatit e forcës. Që nga shoqëritë që kihin dalur nga diktaturat e djathta në Spanjë, Portugal e Greqi e deri te ato që kanë dalur nga diktaturat e majta të ish kampit sovjetik si vendet e Evropës Qendrore dhe republikat baltike, BE-ja ka ndihmuar transformimin e tyre duke kushtëzuar përkrahjen materiale me ndryshimet në sistemin ekonomik dhe politik.

Kjo paradigmë në Kosovë nuk qe zbatuar. BE-ja qe ingranuar në një sistem jofunksional të OKB-së. Tash është koha të ndryshojë, duke ndryshuar tërë filozofinë, prej menaxhimit në kushtëzim.

Në fakt, kjo politikë e kushtëzimit, por në një nivel tjetër tashmë ka filluar. Bashkimi Evropian ka tri modele të

ndryshme për një proces të njëjtë që e quan të Stabilizim-Asociimit. Kjo është një po ardhomë për atë që është dhoma kryesore, pra e kandidaturës zyrtare për aderim në BE. Vendet e Ballkanit perëndimor duhet të kalojnë nëpër këtë proces përmbushjes së kushteve për të arritur në shpallje kandidature.

Njëri model, ai normal, qe përdorur për shtetet si Kroacia, Maqedonia e Shqipëria.

Një tjetër, ai i quajtur paralel, për Serbinë e Malin e Zi, duke ofruar dy kanale, një për Serbinë dhe tjetrin për Malin e Zi.

I treti, i quajtur "mekanizëm përcjellës", u shpik për Kosovën.

Këto të tri modele tregojnë ecjen paralele mes përcaktimit të statusit të Kosovës dhe shpejtësisë integruese në Evropë.

E kjo shihet qartë edhe me një gjest tejet simbolik.

vazhdon në faqen 7

Kuvendi dhe bisedimet

Ramush Tahiri, këshilltar i lartë politik i kryetarit të Kuvendit

Cili do të jetë roli i Kuvendit të Kosovës në procesin e negociatave për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Cili do të jetë roli i Kuvendit në raport me Ekipin Negociator të Kosovës. Cili do të jetë roli i Kuvendit në marrjen e vendimeve në dhënien e pëqimeve, në bërjen e platformave dhe dokumenteve të tjera.

Tash pas gjashtë vjet të administrimit ndërkombëtar të Kosovës më në fund është hapur procesi i përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Kjo është në harmoni edhe me dokumentin bazë me të cilin edhe është vendosur administrimi ndërkombëtar i Kosovës dhe gjithashtu është në harmoni edhe me synimet ndërkombëtare që çështja e Kosovës si çështje e hapur të përmbillet dhe që Kosova të jetë një faktor stabiliteti, një vend demokratik ku respektohen të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve pa dallim e gjithsesi kjo është në harmoni edhe me vullnetin e shprehur lirshëm të popullit të Kosovës.

Ka një konsensus të përgjithshëm se gjendja e

papërcaktuar rreth Kosovës nuk mund të qëndroj si e tillë dhe nuk mund të prodhojë stabilitet për çka edhe duhet të ndryshohet.

Nëkohën tashmë të përcaktuar për bisedimet që do të sillnin deri te një marrëveshje apo një vendim për përcaktimin e statusit të Kosovës, në kohën kur të gjitha palët e interesuara tashmë kanë caktuar ekipet e veta për bisedime, shtrohet çështja e përgjegjësive dhe e obligimeve të organeve dhe institucioneve të Kosovës karshi kësaj problematike vendimtare për të ardhmen e qytetarëve të Kosovës dhe për të ardhmen e rajonit.

Duke pasur parasysh disa parime dhe kriteret bazë që determinojnë këto bisedime që janë dhënë edhe nga Grupi i Kontaktit, dhe duke ditur faktin se bisedimet, zhvillohen për të ardhmen e një territori dhe të qytetarëve të saj dhe se këto nuk janë bisedime ndërmjet dy kombeve, nuk janë bisedime ndëretnike, atëherë përgjegjësia e Kuvendit të Kosovës si organit më përfaqësues të popullit të Kosovës është tejet e madhe

dhe e një rëndësie të dorës së parë duke marrë parasysh se në Kuvendin e Kosovës janë të përfaqësuara më se 17 parti politike dhe gjithashtu janë të përfaqësuara të gjitha grupet etnike dhe shtresat e tjera të shoqërisë kosovare.

Duke mos e vënë asnjëherë në dyshim që Kuvendi i Kosovës ka përgjegjësinë dhe do të kryejë obligimet e veta në ndërtimin e Platformës edhe për bisedime edhe të Platformës për përcaktimin e statusit të ardhshëm e gjithashtu edhe në zgjedhjen e Ekipit Negociator si dhe në miratimin dhe ratifikimin e vendimeve apo marrëveshjeve përkatëse, Kuvendi i Kosovës ashtu si edhe Qeveria ka kapacitete të duhura që të kyçet drejtpërdrejtë në bisedimet për statusin e gjithsesi më shumë në përgatitjet dhe në ndihmat konkrete për të gjitha çështjet që janë objekt i bisedave apo i marrëveshjeve.

Miratimi i Ekipit Negociator nga Kuvendi i Kosovës sipas propozimit të Presidentit të Kosovës, aprovimi i Rezolutës për Njohjen e Vullnetit të popullit për Kosovën shtet të Pavarur dhe Sovran janë veprimet që tashmë i ka ndërmarrë Kuvendi i Kosovës e që së bashku me përfaqësimin e Kuvendit në Ekipin Negociator të Kosovës nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit, e forcon rolin kushtetues të Kuvendit dhe i mundëson atij pjesëmarrje aktive dhe vendimtare në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e fatit të

Kosovës.

Është mençuri që Ekipi Negociatave është i ndërtuar nga përfaqësuesit e tri institucioneve, Presidentit, Kryeministrit dhe Kryeparlamentarit dhe nga përfaqësuesit e dy partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës dhe ORA-s, sepse në këtë bazë sigurohet një pajtueshmëri e plotë ndërmjet tij dhe Kuvendit, duke siguruar edhe votat e nevojshme për miratimin e çështjeve që procedohen në Kuvend nga Ekipi apo që shtrohen për debat nga vet deputetët e Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës do të kyçet në punën e grupeve punuese përmes komisioneve përkatëse parlamentare ose përmes vet deputetëve ekspertë të fushave të caktuara. Kuvendi do të ofrojë hapësirë për punë, kushte teknike dhe personel ndihmës nga administrata...

Pjesëmarrja aktive e institucioneve legale dhe legjitime të Kosovës, veçanërisht e Kuvendit të Kosovës në procesin e bisedimeve dhe të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës është një domosdoshmëri nga fakti se institucionet përfaqësojnë vullnetin e popullit të dëshmuar përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike, dhe krijojnë respektimin e qëndrueshmërinë e vendimeve që merren për Kosovën dhe në emër të Kosovës.



Kohë vendimtare për Kosovën

Mark Dickinson, Udhëheqës i Zyrës Ndërlidhëse të Mbretërisë së Bashkuar

Në dy muajt e fundit janë marrur vendime historike për Kosovën, duke arritur kulminacionin me fillimin e procesit të statusit përfundimtar. Në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm do të mirren edhe më shumë vendime; tani është koha për udhëheqësit e Kosovës, që ta përgadisin vetveten që të marrin pjesë plotësisht në këtë proces, proces për të cilin, shumë njerëz kanë punuar me vite të tëra.

Si anëtar i Grupit të Kontaktit, MB e mirëpriti raportin e Kai Eide's, i cili u publikua në tetor dhe rekomandimi pasues nga Sekretari i Përgjithshëm për lansimin e procesit për përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ne poashtu e mirëpresim për zëmësisht caktimin e Martti Ahtisaari-it për udhëheqjen e këtij procesi; askush nuk do të mund të paramendonte një ndërmjetësues më të kualifikuar apo më të përshtatshëm.

Vizita e të dërguarit të posaçëm Kosovës, në mes të muajit nëntor shënoi fillimin e procesit për statusin përfundimtar. Pasi që kjo ka filluar tani, nuk mund të bllokohet dhe duhet t'i vihet fundi. Rezultati i këtij procesi do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në gjeneratat e ardhshme. Prandaj, është shumë me rëndësi, që të gjitha komunitetet në Kosovë të jenë plotësisht të përgaditura për bisedime. Është posaçërisht me rëndësi që komunitetet minoritare të Kosovës, duke përfshirë komunitetin serb, duhet t'u ipet mundësia për shprehjen e mendimit të tyre dhe të diskutojnë për interesat e tyre. Grupi i Kontaktit ka kërkuar nga autoritetet në Beograd, që t'i inkurajojnë serbët e Kosovës,

që të zënë vendin e tyre në institucionet e Kosovës. Është me rëndësi, që dialogu brenda Kosovës, ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit dhe ndërmjet të gjitha komuniteteve në rajon duhet të vazhdojë dhe ta ndihmojë procesin. Grupi i Kontaktit është pajtuar që dhjetë parimet e gjera udhëzuese t'a farkëtojnë rezultatit e procesit të statusit. Këto përjashtojnë mundësinë e kthimit në gjendjen e para muajit mars të vitit 1999. Nuk mund të bëhet asnjë ndryshim në territorin e tanishëm të Kosovës, d.m.th. nuk ka ndarje të Kosovës apo bashkim me ndonjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti. Integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve rajonal duhet të respektohet plotësisht. Zgjedhja e statusit duhet t'i siguroj Kosovës siguri dhe që, Kosova të mos paraqet ndonjë kërcënim ushtarak apo kërcënim sigurie për fqinjët e saj. Duhet të përfshihen dispozita të veqanta mbi aranzhimin e sigurisë.


Veç kësaj, zgjedhja duhet të siguroj multi-etnicitetin të qëndrueshëm në Kosovë. Duhet të siguroj garanci kushtetuese efikase dhe mekanizma të fortë, që t'i siguroj të drejtat e njeriut të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kjo përfshin të drejtën e refugjatëve dhe personave të zhvendosur, që të kthehen në shtëpitë e tyre dhe të integrohen në komunitet. Mekanizmat duhet të ia mundësojnë të gjitha komuniteteve të Kosovës, që të marrin pjesë në të dyja këto, në qeverinë lokale dhe atë qëndrore. Strukturat efikase të vetëqeverisjes lokale, të krijuara përmes procesit të decentralizimit duhet të sigurojnë qasje të paanshme dhe më të mirë në shërbime publike. Veç kësaj, zgjedhja e statusit të Kosovës duhet të

përfshijë mbrojtës të posaçëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe religjioze në Kosovë. Kjo duhet t'i përfshijë dispozitat, duke specifikuar statusin e institucioneve të kishave ortodokse serbe dhe vendndodhjet tjera kulturore dhe religjioze në Kosovë.

Zgjedhja e statusit të Kosovës duhet të ketë parasysh avancimin e mekanizmave efikas që të zbatoj sundimin e ligjit, ta luftoj krimin e organizuar dhe terrorizmin dhe ta ruaj karakterin multietnik të policisë dhe gjykatave. Sundimi i ligjit është gjëja thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe politik. Investimet në shkallë të lartë do të bëhen në Kosovë, nëse investuesit janë të sigurtë, që kjo është shoqëri funksionale demokratike, ku zbatohet sundimi i ligjit në tërë vendin dhe ku askush nuk është përmbi ligjin.

Veç kësaj, statusi përfundimtar duhet poashtu të jetë plotësisht i kompatibil me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe ligjit ndërkombëtar. Përmbajtja ndaj standardeve europiane është gjëja thelbësore për Kosovën, që ta realizoj ambicien e saj për integrimin në Bashkimin Europian në një moment të caktuar, në të ardhmen. Si mbajtëse aktuale e presidencës së Bashkimit Europian, MB konfirmon përkushtimin e Bashkimit Europian për mbështetjen e procesit, gjatë bisedimeve për status dhe më tej.

Por, çfarëdo, që të ndodh, statusi përfundimtar si i vetëm nuk mund t'i sjell prosperitet Kosovës. Është çështje vitale, që implementimi i standardeve për Kosovën të vazhdojë në kombinim me punën e të Dërguarit Special për bisedimet



mbi statusin përfundimtar. Përmbushja e tërë standardeve do të ndihmojë në krijimin e një shoqërie më të mirë për të gjithë, por poashtu, do të ndikoj në ecjen e mëtejshme dhe rezultatet e procesit të statusit përfundimtar. Kjo poashtu do ta përcaktoj shpejtësinë me, të cilën Kosova do të jetë në gjendje të aderohet në Bashkimin Europian. Raporti i Eide's ofron udhërrëfyesin e rrugëtimit, që Kosova duhet ta ndjek në përmbushjen e standardeve.

Vendimi përfundimtar mbi Statusin Kosovës duhet të miratohet nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Nuk i përket qeverisë britanike, të thotë se çfarë do të jetë statusi përfundimtar – madje, edhe, nëse jemi të vetëdijshëm për atë se çfarë dëshirojnë shumica e qytetarëve të Kosovës. Procesi i statusit përfundimtar nuk do të jetë i lehtë. Nga të gjitha palët do të kërkohet që t'i përgadisin pozitat negociuese, në detaje dhe të pajtohen mbi çështjet, ku ata mund të bëjnë kompromise edhe për çështjet, që nuk do të mundën. Do të duhet të mirren vendime të vështira. Por, është koha të shkohet më tutje nga e kaluara dhe të shikohet kah e ardhmja. Procesi i pajtimit, megjithëse i dhimbshëm, duhet të fillojë me sigurimin e zhvillimit të një Kosove të qëndrueshme.

Fjala hyrëse e ambasadorit Verner Vnent me rastin e fillimit të programit për zhvillimin e shkathtësive për negocim

30 tetor 2005 - Shkolla e Shërbimit Policor në Kosovë, Vushtrri

Kam kënaqësinë t'ju dëshiroj mirëseardhje në programin për zhvillimin e shkathtësive për negocim. Posaçërisht, jam i nderuar me prezencën e kryeministrit, z. Bajram Kosumi. Njëherit, do të dojat t'i dëshiroj mirëseardhje ekspertëve të Grupit për Politikë dhe të Drejtë Publike Ndërkombëtare -PILPG, z. Paul Uilliams dhe ekipit të tij, të cilët javën e ardhshme do ta kalojnë, duke i këmbyer me ju përvojat dhe njohuritë e tyre.

S'do mend se ky program, i përgatitur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me

Grupin për Politikë dhe të Drejtë Publike Ndërkombëtare dhe Shkollës Ffleçer për Drejtësi dhe Diplomaci, përbën një kontribut të rëndësishëm të mandatit tonë në sigurimin e mbështjetjes dhe ndihmës për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës. Programi përbëhet nga tri module:

- Simulimi i negociatave, që do të përqëndohet në hartimin e kushtetutës së negociuar dhe njëherit do të trajtojë tema si roli i palës së tretë ndërmjetësuese apo objektet kulturore dhe mbrojtja e tyre. Pos kësaj, do

të përfshihet edhe ushtrimi për përgatitjet rreth temës së caktuar, kështu që do të keni rastin të ballafaqoheni më për së afërmi me vështirësitë, që ka të ngjarë të shfaqen gjatë hartimit të marrëveshjes për status. Me këtë rast, do të doja po ashtu të ve në dukje, se nuk do të ketë asnjë përpjekje për paragjykimin e rezultatit që mund të dalë nga bisedimet për status përmes simulimeve apo pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në këto ngjarje.

- Përgatitja e Doracakut për Përpiluesit, ishte hartur

me qëllim që të shërbejë si udhëzues praktik si për palët negociuese ashtu edhe për ekspertët. Doracaku do të jetë i ndarë në një mori çështjesh të përgatitura si modele për t'i pasqyruar ato çështje me të cilat sipas të gjitha gjasave do të ndeshemi gjatë bisedimeve. Secili model do të përmbajë një udhëzues të shkurtër mbi temën, pastaj analizën e detajuar krahasuese të gjuhës së përdorur në marrëveshjet e tjera për paqe, modelin e gjuhës, dhe një përmbledhje të shkurtër të kontekstit politik të marrëveshjeve



vazhdon prej faqes 3

Në kohën kur u hap procesi negociator për statusin e Kosovës, u hap edhe procesi negociator për atë që është në fakt shpejtimit i aderimit të Serbisë në BE. Kështu, Serbia vet mund të kuptojë një realitet tejet të thjeshtë, se sa më shpejtë heq dorë nga Kosova aq më shpejtë do të mund të përgatitet për në BE:

Por, cila mund të jetë ajo vlerë e shtuar për diplomacinë evropiane? Të kenë zgjidhur një çështje statusi, dmth. të kenë njohur një shtet të formuar.

Jo vetëm kaq.

Për Evropën e bashkuar, çështja është që të arrijë të dëshmojë se mund të transformojë shtete me "soft power", fuqinë e vet të butë kushtëzuese. Por, për ta bërë këtë, vendet si Kosova, Mali i Zi dhe Serbia duhet të jenë të fillimisht të pavarura, në mënyrë që të jenë partnere të BE-së.

Në fakt, çështja e transformimit të shteteve, prej pikës së tyre të krizës e deri te funksionaliteti, është ndër sfidat më të mëdha të botës. Për BE-në, është një avantazh që të mund të dëshmojë, karshi krizave në Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore, se një vend si Kosova mund të kalojë prej vatrës së luftës, intervenimit humanitar, protektoratit ndërkombëtar në një shtet bashkëkohor evropian.

Dhe, natyrisht, ky është një interes para së gjithash i vet kosovarëve.

relevante të mëhershme.

- Konceptualizimi i proceseve negociuese dhe përgatitja e strategjisë është i rëndësishëm, për ju, ngase do t'ju bëjë të mundur që të njiheni për së afërmi me aspektet relevante të teorisë së negociimit. Me këtë rast, do të përfshihen temat si dobietë e përbashkëta, shqyrtimi i interesave më përpara se i qëndrimeve, puna me palën e tretë dhe mundësitë/kufizimet e opinionit publik, puna me votuesit. Po kështu, një ndërmjetësues i shquar ndërkombëtar do të vijë në Kosovë për të ofruar sipërvojën e tij ashtu edhe informata lidhur me dokumentet bazike për procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës.

Njëherazi, OSBE-ja është e bindur se të gjitha palëve të përfshira në këtë proces duhet të kenë mundësi të barabarta për t'i thelluar shkathhtësitë e tyre negociuese. Së këndejmi, në fund të muajit nëntor një program i

ngjashëm do t'ju ofrohet edhe serbëve të Kosovës.

Jam i sigurtë, që ju të gjithë do të përfitoni nga këta ekspertët dhe nga përvoja e ofruare e PILPG-së. Përmes këtij programi jo vetëm që do t'i thelloni shkathhtësitë tuaja negociuese por njëherësh do të keni edhe një pasqyrë më të qartë për procesin. Ky program do të jetë i dobishëm veçanërisht për ata që do të jenë ngushtësisht të involvuar në bisedimet për status.

Sot, Kosova gjendet në një moment të rëndësishëm të zhvillimit të saj politik, meqë së shpejti pritet fillimi i bisedimeve për statusin e saj të ardhshëm. Nisur nga kjo, do ta kisha shfrytëzuar rastin që t'i theksoj edhe një herë çështjet në vijim:

Së pari, aftësia e Kosovës, që t'ia siguroj vetes ardhmërinë në Europë do të varet në një masë të madhe nga zotësia e udhëheqësve të saj, që të jenë unikë gjatë gjithë procesit të përcaktimit të statusit të ardhshëm.

Së dyti, Delegacioni Kosovar duhet të përgatitet për të hyrë në negociata. S'ka pikë dyshimi se Delegacionit do t'i nevojitet edhe mbështetje teknike nga grupet punuese, të cilat ende nuk janë themeluar. Ndaj këtu lipsen urgjentisht veprime konkrete.

Dhe së treti, do të doja të ve në dukje se në këtë proces duhet të përfshihen edhe komunitetet kosovare jo shqiptare. Ndaj udhëheqësit e Kosovës duhet ta bëjnë një propozim të qartë për përfshirjen e shqetësimeve të tyre. Kjo është mënyra e vetme për të siguruar përfshirjen e tyre në procesin e përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës.

Në fund, shpresoj se ky program do të jetë i dobishëm për ju. Po kështu, dëshiroj t'ju bëj të ditur se OSBE-ja, po që nevoja, është e gatshme t'ju ofrojë edhe programe të tjera për ndërtimin e kapaciteteve, gjatë rrjedhës së procesit të përcaktimit të statusit të ardhshëm.

Paradigma e ndryshimit: Thelbi i ndryshimit të suksesshëm

Në kuadër të Programit për Mbështetje të Negociatave, z. Rolf Meyer erdhi në Kosovë për ta ofruar përvojën e tij si Kryenegociator në Afrikën Jugore. Në vitin 1990 ndodhi një ndryshim i paradigmes në mënyrën e të menduarit dhe vepruarit politik të qeverisë së Partisë Nacionale (PN), që qeveriste aso kohe, gjë që bëri të mundur përshejtimin e procesit të transformimit të Afrikës Jugore nga një shtet apartheidi në një shtet ku respektohen dhe mbështen të drejtat dhe mundësitë e barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Si anëtarë i ekipit negociator të qeverisë, z. Meyer pati rastin t'i përjetojë këto ndryshime, të cilat i ka përshkruar më poshtë. Programi për Mbështetjen e Negociatave i është ofruar udhëheqësisë politike kosovare dhe ekspertëve për status. Kjo nismë është organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Shkolla Flleçer për Drejtësi dhe Diplomaci tok me Projektin amerikan për Drejtësi në Kohë Tranzicioni.

Rolf Meyer, Kryenegociator në Afrikën Jugore.

Në kuadër të Programit për Mbështetje të Negociatave, z. Rolf Meyer erdhi në Kosovë për ta ofruar përvojën e tij si Kryenegociator në Afrikën Jugore. Në vitin 1990 ndodhi një ndryshim i paradigmes në mënyrën e të menduarit dhe vepruarit politik të qeverisë së Partisë Nacionale (PN), që qeveriste aso kohe, gjë që bëri të mundur përshejtimin e procesit të transformimit të Afrikës Jugore nga një shtet apartheidi në një shtet ku respektohen dhe mbështen të drejtat dhe mundësitë e barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Si anëtarë i ekipit negociator të qeverisë, z. Meyer pati rastin t'i përjetojë këto ndryshime, të cilat i ka përshkruar më poshtë. Programi për Mbështetjen e Negociatave i është ofruar udhëheqësisë politike kosovare dhe ekspertëve për status. Kjo nismë është organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Shkolla Flleçer për Drejtësi dhe Diplomaci tok me Projektin amerikan për Drejtësi në Kohë Tranzicioni.

Përvoja ime si një nga negociatorët kryesorë për qeverinë PN është se liderët politikë dhe negociatorët zakonisht negociojnë nga pozicionet që i kanë të njohura. Vetëm në rastin më të mirë ata janë të gatshëm që ta ndryshojnë pozicionin e tyre me qëllim që t'ia përshtasin kërkesave të palës kundërt. Së këndejmi, të gjitha ndryshimet e politikave që bëhen janë më tepër të natyrës taktike dhe jo thelbësore për gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme të konfliktit. Shumë rrallë ndodh që liderët politikë të rrezikojnë dhe ta sprovonin veten në një fushë të panjohur, ndërsa edhe më rrallë ndodh që ata ta sfidojnë vetveten duke akceptuar qëndrimelargpamëse dhe idealiste për të punuar për një të ardhme të ndryshme. Kështu që, shumë politikanë do të kujtojnë se mbase është shumë më sigurtë që t'i përmbahen një kornize të vjetër, politikisht dhe personalisht, se sa të angazhohen rreth një paradigme të re.

Mirëpo, kalimi nga e vjetra në të reën, nga e kaluara në të ardhmen duhet të bëhet herët a vonë. S'do mend se asnjë konflikt nuk mund të zgjidhet pa përafrimin e pikëpamjeve të kundërta, apo pa shfaqjen e qëndrimeve të reja, që rëndom shënojnë fillimin e largimit nga qëndrimet e vjetra. Kështu që,

kur një shtet, një vend apo një rajon është i përfshirë në konflikt të gjatë shoqëroro-politik dhe është i vendosur që të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme për të cilën bien dakord të gjitha palët, atëherë është e domosdoshme që udhëheqësia e një vendi të tillë t'i mbështesë- por edhe promovojë dhe ndihmojë konkretisht- ndryshimet radikale. Mirëpo, për të ndodhur një gjë e këtillë, mënyra e të menduarit e lidhshimit të partive të një vendi apo rajoni të tillë duhet të ndryshojë në mënyrë rrënjësore. Me fjalë të tjera, kërkohet dhe ka nevojë për një ndryshim të paradigmes.

Karakteristikat e udhëheqësisë në transformim

Fazën e transformit të udhëheqësisë së Afrikës Jugore e kanë karakterizuar me sa vijon:

Stafi i ri pas Konventës (Kongresit) për një Afrikë Jugore Demokratike (CODESA): Dështimi i plotë i CODESA-ës shkaktoi një katarsis, e cila pastaj bëri të mundur që të hiqej dorë nga mënyra e vjetër e të menduarit dhe vepruarit.

Ndryshimi i paradigmes: Rezultati i katarsisit ishte ndryshimi i paradigmes në nivelin personal, të cilat u bënë të njohuara edhe në nivelin politik dhe procedural dhe kësodore bënë të mundur zhvillimin e një procesi negociator krejtësisht të ndryshëm për nga cilësia nga

negociatat e mëparshme.

Udhëheqësia e Kongresit Nacional Afrikan (ANC) dhe PN-ja, na kanë besuar mua dhe Cyril Ramaphosa-së avansimin e procesit. Kështu që, gjatë punës sonë si negociatorë, ndryshimi i paradigmes ishte evident në marrëdhëniet tona dhe procesin negociator sidomos në këto aspekte:

Besimi: Besimi i krijuar midis Ramaphosa-së dhe meje ishte vendimtar jo vetëm për arritjen e marrëveshjes për të ecur përpara, por edhe për procesin aktual të hartimit të kushtetutës. Ne mendonim se si ekip nuk do të ketë probleme të pakapërcyeshme për ne, madje edhe në rastet kur dukej se kishte çështje dhe probleme të pazgjidshme midis nesh.

Besimi i përbashkët: Si Ramaphosa ashtu dhe unë besonim se e vetmja zgjidhje e qëndrueshme për Afrikën e Jugut është ajo që del nga një marrëveshje e negociuar.

Pronësia e përbashkët për vizionin e përbashkët: Ndonëse vinim nga mjedise të kundërta Ramaphosa dhe unë ishim të përkushtuar dhe të vendosur për sëndërtimin e vizionit për të krijuar një shtet kushtetues dhe për të siguruar demokraci në Afrikën Jugore.

Gatishmëria për të hequr dorë nga qëndrimet e mëparshme: Meqë kishim rënë dakord



rreth qëllimit tonë bazë, ne hoqëm dorë nga qëndrimet e mëhershme dhe pozitat e ngurta ideologjike të panegociueshme.

Parimi Win/win (ku të dy palët fitojnë): Vizioni ynë i përbashkët bëri të mundur që të kemi një pronësi të përbashkët në procesin e negociatave dhe kështu krijuam një bazë të mirë për arritjen e një zgjidhjeje win/win (ku të gjitha palët fitojnë). Ne krijuam besimin se arritja e një zgjidhjeje të përbashkët është e mundshme.

Respekti ndaj mendimeve të ndryshme: Përmes besimit të ndërsjellë ne krijuam një dëshirë të mirëfillët për t'i dëgjuar dhe kuptuar qëllimet dhe opinionet e shoqi-shoijt. Ne madje bëmë përpasje për të depërtuar edhe më tepër në mendjet e njërit-tjetrit, duke respektuar origjinën e shoqi-shoijt.

Për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në mesin tonë, ne tani jo vetëm që ia dolëm mbanë tu japim udhëzime ekipeve negociatore, por njëherit edhe që t'i motivojmë ato. Kjo u vërejt fare mirë sidomos në këto aspekte:

Besimi në arritjen e një zgjidhjeje më të mirë: Ekipeve punuan për një vizion të përbashkët me qëllim që të krijojnë një Afrikë Jugore demokratike.

Kredibiliteti: Për dallim nga e shkuara tanimë ekipeve nuk ktheheshin tek premtimet dhe koncesionet. Kështu që ekzistonte një standard i lartë moral dhe etik.

Dialogjet gjithëpërfshirëse: Me mirëbesim, respekt, dhe vizion të ndërsjellë të dy ekipeve u përqëndruan në dialog gjithëpërfshirës në vend se ta harxhojnë energjinë në dallime të vogla.

Përqëndrimi rreth gjetjes së zgjidhjeve për çështje dhe probleme të mëdha: Palët kundërshtarë përqëndroheshin në gjetjen e zgjidhjeve për

çështje komplekse procedurale lidhur me procesin negociator dhe përmbajtjen e kushtetutës. Madje, ishin krijuar edhe rrethana dhe mundësitë për parti të ndryshme që të angazhoheshin në debate të mirëfillëta rreth detajeve të kushtetutës së përkohshme. As kurrë në historinë e vendit nuk kanë punuar të zinjët dhe të bardhët së bashku si të barabartë, duke bërë të mundur kështu krijimin e një të ardhmeje dhe fati të përbashkët, si partnerë.

Ndërtimi i imazhit pozitiv: Gjatë debatave të mëparshme kundërshtarët takoheshin vetëm për vetëm. Kjo do të thotë se imazhet e mëparshme të impersonalizuara të armikut ishin rishqyrtuar dhe zëvendësuar me respekt.

Inkluziviteti: Aso kohe në negociatat shumëpalëshe mermin pjesë më tepër se njëzet parti politike, struktura qeveritare dhe liderët tradicional të grupeve. Kjo bëri të mundur që asnjë grup të mos mbetej pa u përfshirë në proces. Së këndjemi, si partitë e mëdha ashtu edhe ato të vogla patën shanse të barabarta për t'u përfshirë në proces. Ndonëse ca parti, nga të cilat Partia e Lirisë Inkatha (IFP) ishte më e rëndësishmja u tërhoq nga forumet shumëpalëshe në një fazë të caktuar të procesit, megjithatë, bashkëveprimi bilateral me ta askurrë nuk reshti dhe amandamentet e negociuara për kushtetutën e përkohshme u bënë me qëllim që të plotësoheshin dëshirat dhe kërkesat e tyre. S'do mend se natyra gjithëpërfshirëse e procesit rezultoi në pjesëmarrjen e një numri jashtëzakonisht të madh të votuesve dhe partive në zgjedhjet e para demokratike dhe transformimin paqësor që pasoi.

Pos kësaj, duhet thënë se edhe gjatë pjesës formale të procesit ishte evident ndryshimi i

paradigmës. Në vijim po i japim disa shembuj:

Parimet në vend të dogmës: 'Parimi' duhet të shihet dhe kuptohet si 'krijim i terrenit të përbashkët', i cili arrihet përmes konsultimeve.

Datat e synuara: Si pjesë e pronësisë së përbashkët kishte nevojë që të jipnim udhëzime dha ta drejtonim procesin nga një përfundimi logjik, ndaj dhe afatet kohore luajtën një rol esencial gjatë procesit. Së këtejmi, qasja për të respektuar datat e synuara, në mesin e tyre edhe datën e caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve, bëri që negociatorët të punojnë me përkushtim dhe përqëndrim të plotë. Të punuarit sipas afatave kohore bëri të mundur që jo vetëm të forcohet besimi, por ishte edhe mjet efikas për kontrollimin e ndjenjave të komuniteteve zezake, tek të cilat shqetësimi vazhdimisht po rritej, veçanërisht kur kishte incidente të dhunshmesikundër që ishte ai i prillit të vitit 1993 kur u vra Chris Hani, një nga liderët më të popullarizuar.

Një kushtetutë komplete: Pjesa kryesore e negociatave, e cila përfundoi në nëntor të vitit 1993 rezultoi në hartimin e një kushtetute të re të përkohshme, të një Projektligji për të Drejtat dhe dispozitave për implementimin e vendimit për krijimin e gjykatës kushtetuese dhe institucioneve të ndryshme për të mbështetur demokracinë e re.

Në marrëdhëniet tona me mediat, përmes të tyre edhe me gjithë vendin, ndryshimi i paradigmatë vërehej në:

Transparencë: Negociatat shumëpalëshe ishin të hapura për media. Një efekt i paparashikueshëm që u arrit ishte se falë prezencës së mediave ne mësuam se si të përmbahemi nga shprehja e agresivitetit tonë. Madje edhe kur ngriteshin

tensionet midis palëve, dhe shtrëngoheshin që ato çështje t'i zgjidhnin në prezencë të kamerave, rezultatet do të shpalleshin në forumin shumëpalësh haptazi.

Informimi i publikut: Mediat kanë bërë të mundur që votuesit tanë të jenë të informuar gjatë gjithë kohës. Kjo bëri që shqetësimet e votuesve të zvogëlohen. Kjo ishte njëra nga mënyrat se si u arrit jo vetëm mbështetja për bisedime por edhe rezultati i tyre. Informimi dhe reflektimi i mediave mbi aktivitetet e negociatave ishte kryesisht objektiv, gazetaria e tyre hulumtuese bëri të mundur që të informohen si qytetarët ashtu edhe negociatorët dhe njëherazi krijoi një dinamikë interaksioni.

Konkluzionet

Disa afrikanojugorë të bardhë sot mohojnë se e kanë përkrahur ndonjëherë aparteidin; ca të tjerët do të thonin se në të vëretë të apartehedi nuk ka qenë edhe aq i keq. E vëreteta është se praktikisht të gjithë të bardhët e kanë mbështetur apartehedin, madje edhe unë, dhe kjo ka qenë një gjë shumë destruktive. E përmenda këtë fakt, ngase është më rëndësi, kujtoj unë, që të mos iket nga realiteti. Për mua është shumë me rëndësi që të pranoj se dikur vëretë kam përfituar nga ai regjim, dhe se kam qenë pjesë e strukturës që e ka mbështetur atë. Mirëpo, do të doja të theksoja se përkundër kësaj, megjithatë ishte e mundur si për mua ashtu edhe për të tjerët, që ta ndryshojmë dhe të kalojmë nga paradigma e vjetër në të re, dhe kështu të luajmë rol aktiv në krijimin e një Afrike Jugore të re dhe demokratike. Fare në fund, dëshiroj të vë në dukje se nëse ekzistojnë vullneti dhe besimi në perspektivën e paqes së qëndrueshme, atëherë mund të zgjidhet çdo konflikt, madje edhe ai që ka zgjatuar më tepër se tre shekuj.

Përmirësimi i shkathtësive negociuese përmes simulimit, hartimi i ligjeve

Më 30-31 tetor dhe 4-5 nëntor, më shumë se 40 pjesarë të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ-ve) dhe Kuvendit morrën pjesë në Trajnimin për Shkathtësi Negociuese të mbajtur nga E drejta Ndërkombëtare Publike & Grupi për Politika (PILPG). Organizuar nën mandatin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Programi trajnues i inkurajoi pjesmarrësit të sajojnë zgjidhje inovative për vështirësitë e mundshme gjatë negociatave për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Paul Williams, drejtor, E Drejta Ndërkombëtare Publike dhe Grupi për Politika (PILPG)



PILPG-ja shpresonte të përmirësoj ndjeshmërinë e pjesmarrësve për interesat e palëve tjera, si edhe të kuptuarit e çështjeve të vështira ligjore. Pjesmarrësit janë emëruar nga udhëheqësit partiak dhe përfaqësonin secilën prej katër partive politike kyesore: LDK-në, AAK-në, PDK-në, dhe ORA-ën. Ka patur pjesmarrës edhe nga ministritë e IPVQ-ve dhe nga zyrja e krye ministrit.

Trajnimi u mbajt në dy pjesë. Komponentja e parë që simulim i negociatave të bazuara në Kushtetutën e Irakut. Simulimi ka qenë i planifikuar sipas metodologjisë së zbatuar nga Qendra Trajnuese e Departamentit të Shteteve të Bashkuara për Punë të Jashtme, e cila përdor simulimet për negociatave, që ti trajnoj diplomatët amerikan para ndërmjetësimeve dhe negocijimeve.

Përderisa secilit pjesmarrës iu caktua roli i delegacionit në Kongresin Kushtetues të Irakut, PILPG-ja zgjidhi temat që mund

të ngriteshin gjatë zhvillimit të negociatave të Kosovës siq është roli i komunitetit ndërkombëtar, përgjegjësitë e reja të Qeverisë (së Kosovës), decentralizimi dhe qeveria lokale, dhe mbrojtja e vendndodhjeve religjioze e historike dhe të drejtat e minoriteteve. Pastaj, simulimi përfshinte një ushtrim draftimi për temat specifike, në mënyrë që pjesmarrësit të mund të familjarizoheshin me vështirësitë që mund të paraqiteshin gjatë draftimit të marrëveshjes për statusin përfundimtar. Ushtrimi përfundoi me diskutimin e të gjithë pjesmarrësve për "mësimet e mësuara" gjatë zhvillimit të këtyre udhëzimeve.

PILPG-ja nuk është përpjekur të paragjkoj rezultatin e këtyre ushtrimeve apo t'i drejtoj pjesmarrësit kah ndonjë rezultat i caktuar. Më saktësisht, simulimet kishin qëllim t'i theksonin çështjet kyçe që nevojiten të zgjidhen dhe zotërimin e një paqeje jetëgjatë në Kosovë.

Për komponentin e dytë të programit, PILPG-ja ka krijuar një përmbledhje të shkurtër për pjesmarrësit. Përmbledhja shërben si një udhëzues praktik për negocijim dhe draftimin e marrëveshjes së statusit përfundimtar. Dokumenti jep sqarime se si të interpertohen marrëveshjet politike në gjuhën e marrëveshjeve me zotësi ligjore. Në seancat me grupe të vogla jemi fokusuar në zhdërvjelltësimin e dispozitave nëatëmnyrë, që dotalehtësonte punën e implementimit.

Përmbledhja përmbante shabllone për ato çështje që kanë më së shumti gjasa të paraqiten gjatë negociatave për statusin e ardhshëm dhe çështjet paralele të paraqitura në simulim. Çdo shabllon shkurtimisht përmbledhte lëndën, gjuhën relevante nga marrëveshjet paqësore të mëparshme dhe modelin e gjuhës së sugjeruar.

Të gjithë pjesmarrësit diskutonin çështjet me çiltërsi dhe në mënyrë të hapur. Natyrisht, se ka patur mosmarrëveshje, por pjesmarrësit treguan shkathtësi ndërmjetësimi, bërje kompromisi dhe shkathtësi negocijimi gjatë tërë kohës së trajnimit. Çuditërisht, pjesmarrësit punuan përtej vijave partiake. Ata nuk kanë kërkuar patjetër të kenë qëndrimin e partisë së tyre, së cilës ata i takojnë, por kërkuan kompromise me pjesarët e delegacionit të tyre, shkëmbyen

idetë dhe mbështetjen e tyre.

Poashtu, dukej se pjesmarrësit kuptuan urgjencën e shoqëruar me përgaditjen për negocijim ndërkombëtar. Draftimi i platformës, dhe sigurimi i mbështetjes në masë krahas interesave të ndryshme mund të jetë proces i gjatë dhe i vështirë. PILPG-ja ka kërkuar nga pjesmarrësit të draftojnë deklaratën hipotetike të parimeve. Të punuarit në grupe të vogla në kohë prej më shumë se dy ditë, pjesmarrësit zhvilluan negociatave dhe draftuan një platformë prej 20 parimeve, që përmbanin dispozita për statusin e ardhshëm, prezencë të vazhdueshme ndërkombëtare, mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut dhe mbështetje për sundimin e ligjit. Kjo platformë i është prezentuar Ekipit të Delagacionit Kosovar.

Ndoshta, ajo më e rëndësishmja është se, programi trajnues ka gjeneruar një dobi të veçantë. Pjesmarrësit me përkushtim zotëruan çështjet e paraqitura dhe zhvilluan ndjenjën e përgjegjësisë ndaj zgjidhjes së këtyre çështjeve, ku shumica na bëri me dije se kjo ishte hera e parë, që iu ishte dhënë mundësia e shprehjes së mendimeve të tyre. Të tjerët pohuan se ky program i shtyu ata të mendojnë për çështjet tjera të lidhura me ato, që ishin diskutuar gjatë zhvillimit të projektit.

Shkolla e Filleçërit për Drejtësi dhe Diplomaci ofron trajnime për negociata për liderët serbë dhe shqiptarë në Kosovë

Profesor Ajlin Babit, drejtoreshë në Programin për Zgjedhjen e Konfliktëve dhe Negociatat Ndërkombtare pranë Shkollës Filleçër të Drejtësisë dhe Diplomacisë (SHBA).

*M*e kërkesën e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Shkolla e Filleçërit për Drejtësi dhe Diplomaci nga Universiteti i Tuftsit SHBA ka dizajnuar dhe mbajtur dy programe trajnimi për negociata gjatë muajit nëntor 2005. Këto trajnime kishin synuan ngritjen e efikasitetit të aftësive negociuese të liderit politik serbë dhe shqiptarë në Kosovë. Arsyeja pse ishin të kyqyra të dy palët ishte që sa më të përgatitur dhe aftësuar të jenë liderët e të dy palëve të negociimit aq më të mëdha do të jenë rezultatet për secilën palë. Dhe kjo për faktin që të dy grupet do të çmohen më shumë punën për ruajtjen e interesave sesa të pozicioneve, dhe për të gjetur opzione më kreative për të pëmbushur interesat e të gjithëve.

Programi i parë trajnues është mbajtur më 10-12 Nëntor në Hotelin Pallas në Mitrovicë me grupin e dalluar të liderëve politik shqiptarë të Kosovës. Programi ishte përgatitur në bashkëpunim me Projektin e SHBA-ve për Drejtësi në Periudhën e Tranzicionit. Trajnuesit ishin profesoret Ajlin Babit dhe Diana Çigas nga Shkolla e Filleçërit, të cilët ligjërojnë mbi negociimin dhe kanë përvojë të madhe në udhëheqjen e programeve trajnuese mbi negociimin me liderë politikë dhe të biznesit në të gjitha vendet e botës. Ato gjithashtu kanë mbajtur trajnime për shumë vite edhe

në vendet e ish-Jugosllavisë.

Ato ishin të shoqëruara nga z. Rolf Mejer, ish Ministër i Mbrojtjes në qeverinë e Afrikës Jugore dhe negociatori kryesor për Partinë Nacionale në negociatat që rezultuan në marrëveshjen historike për paqë në Afrikë Jugore. Ai shkëmbeu përvojat e tij me pjesëmarrësit dhe ofrojë një vështrim mbi qasjen e mundshme në bisedimet e ardhshme mbi statusin. Përveq kësaj ekipit iu bashkangjiti në ditën e tretë të punës edhe z. Wolfgang Petriq, ambasadori i tanishëm austriak në Kombet e Bashkuara në Gjenevë dhe ish i Dërguari i BE-së për Kosovën dhe ndërmjetësuesi BE-së në negociatat në Rambuje. Z. Petriq ka shqyrtuar Parimet udhëzuese për zgjedhjen e statusit të Kosovës dhe reagimin e BE-së ndaj këtyre parimeve.

Programi i dytë trajnues është mbajtur më 27-28 nëntor në Brezovicë me një grup poaq të daluar politikanësh serbë të Kosovës. Trajnuesit ishin Profesor Babit nga Shkolla Filleçër dhe dr. Dejvid Still nga Grupi për Menaxhimin e Konfliktëve/Mercy Corps nga SHBA-të. Ata ishin të shoqëruar nga z. Millorad Pupovac deputet në Parlamentin Kroat. Mes arritjesh të shumta z. Pupovac ka marrë pjesë edhe në diskutimet e vitit 1997 për



riintegrimin e Sllavonisë Lindore. Në këtë program trajnues, ai ka shqyrtuar mësimet e mësuara për negociimin gjatë shumë viteve me përvojë si lider politik në Kroaci dhe ka sugjeruar sërëbët e Kosovës mbi strategjitë e mundshme gjatë bisedimeve.

Gjatë të dy programeve të trajnimit, theksi ishte vënë mbi rëndësinë e përgatitjes dhe analizave. Trajnuesit dhe panelistët musafor kanë theksuar vlerën e të përgatiturit paraprakisht gjatë negociatave për tju shmangur ndonjë të papriturë më vonë. Kjo mundëson që kreativiteti dhe analizat të vijnë në shprehje për të shmangur reagimet mbrojtëse të cilat bllokojnë proceset. Përgatitjet kryesore kanë të bëjnë me të kuptuarit e drejtë të intereseve themelore të grupit përkatës dhe grupit që ulet përballë.

Negociimi efektiv ka të bëjë me të kuptuarit e motiveve, shqetësimeve dhe frikave që shoqërojnë kërkesat që duken të panegociueshme dhe të papajtueshme. Dhe për rezultat arrijmë deri tek qasjet kreative që u përgjigjen interesave të të dy palëve jo vetëm njëri. Zgjedhjet e tilla kreative janë gjithnjë më të qëndrueshme sesa ato që vijnë të imponuara apo për të cilat ekziston bindja se i sjellin dobi më shumë njëri palë kundruall tjetrit.

Gjithë trajnuesitë dhe panelistët e ftuar kanë shprehur falënderimet për mundësinë për të punuar me komunitetet në Kosovë në këto momente të rëndësishme për procesin e negociimit, dhe kanë shprehur interesimin e tyre OSBE-së dhe pjesëmarrësve tjerë për të qenë të involvuar gjatë tërë rrjedhës së procesit.

“Serbët nuk janë vetëm pjesë e problemit, ata janë edhe pjesë e zgjidhjes”

Me 27 dhe 28 nëntor Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një program për zhvillimin e shkathtësive negociuese për liderët serbë të Kosovës. Programi u drejtua nga Shkolla Filleçer për Drejtësi dhe Diplomaci (ShBA) në të cilën morri pjesë edhe Dr. Milorad Pupovac, kryesues Këshillit Nacional Serb në Kroaci. Njëherit, në këtë ngjarje mori pjesë edhe z. Oliver Ivanoviq, kryesues i Listës Serbe për Kosovë dhe Metohi. Më poshtë po i japim ca reflektime të tij lidhur me rolin që mund të luajnë politikanët serbë të Kosovës në bisedimet e ardhshme për status.

Intervistoi Biserka Ivanoviq, Misioni i OSBE-së në Kosovë

ASI: Si e vlerësoni programin për shkathtësitë negociuese, të mbajtur kohë më parë për politikanët serbë?

Oliver Ivanoviq: Ishte një mundësi e shkëlqyeshme për shumë njerëz tanë, të cilët janë aktivë në politikë dhe të cilët nuk kanë pasur rastin gjerë më tani, që të mësojnë diçka rreth teknikave negociuese. Ishte një rast i mirë për të gjithë ne për të kuptuar më mirë se çfarë është interesi ynë në negociata.

Politikani i rëndomtë serb zakonisht e di fort mirë se çfarë nuk dëshiron. Ndonëse, ai shpeshherë nuk ia del mbanë që ta arrijë atë që dëshiron. Në të vërtetë, ata zakonisht mendojnë se mjafton që vetëm t'i artikulojnë mendimet dhe qëndrimet mbi një çështje të caktuar në mënyrë të hapur dhe lucide. Kështu që, ai zakonisht i shpërfill pikëpamjet e palës tjetër për çështje të caktuara, por dihet se në negociata nuk shkon kështu. Një qasje e këtillë mund t'ia lejojë vetvetes vetëm ai që mund ta realizojë zgjidhjen e çështjes së tij. Ndërkaq, dihet se ekziston vetëm një superfuqi në botë e ata nuk janë serbët!

ASI: Çfarë mendoni se ishte arritja më e madhe e këtij programi?

Oliver Ivanoviq: S'do mend se para së gjithash suksesi i parë është që në këtë program morën pjesë shumë pjesëmarrës të rinjë nga pjesa qendrore e Kosovës.

Ata e kuptojnë rëndësinë e negociatave, ngase ka të bëjë me mbijetesën e tyre. Kujtoj se të gjithë pjesëmarrësit ishin shumë të interesuar dhe të hapur gjatë elaborimit të qëndrimeve të tyre.

ASI: Për çfarë tjetër mendoni se ka nevojë ende?

Oliver Ivanoviq: Mendoj se nuk ia dolëm mbanë që ta zhvillojmë simulimin e negociatave aktuale për bisedimet rreth statusit. Mbase, me këtë rast, do të ishte me interes të veçantë nëse pjesëmarrësit do të kishin lozur role të ndryshme, si fjala vjen rolin e delegacionit të qeverisë së Serbisë, delegacionit të shqiptarëve të Kosovës, përfaqësuesve të Grupit të Kontaktit dhe Marti Ahtisarit. Nëse nuk i luajmë këto role, ne nuk do të mund t'i kuptojmë qëndrimet e të gjithë atyre me të cilët do të duhet të bisedojmë.

ASI: Çfarë prisni tani në fillim të bisedimeve për status?

Oliver Ivanoviq: Pres që negociatat të jenë paqësore dhe pa dhunë. Pres që së shpejti negociatat të kalojnë në fazën e bisedimeve direkte. Njëherazi, parashikoj që do të ketë vendime të njëanshme. Jam plotësisht dakord me parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit.

ASI: Ku e shihni ju pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në bisedimet e ardhshme?

Oliver Ivanoviq: Pjesëmarrja



jonë do të jetë jashtëzakonisht frytëdhënëse nëse marrim pjesë në bisedimet për decentralizimin. Ne e kemi të qartë se çfarë presim nga ky proces. Pjesëmarrja jonë direkte duhet të ndërlihet me situatën e sigurisë. Problemi i kthimit nuk do të mund të zgjidhet përdersia nuk i pajtojmë disa faktorë relevantë: Shtetin serb, PSSP-ën, shqiptarët e Kosovës, UNMIK-un dhe bashkësinë ndërkombëtare. Gjerë më tani kësaj çështjeje i janë qasur në mënyrë të gabuar, nuk ka ekzistuar një bashkëpunim i mjaftueshëm me PSSP-ën dhe UNMIK-un dhe nuk ka pasur ndikim të mirëfillt të serbëve të Kosovës.

Një detyrë e veçantë e serbëve do të jetë që të bëjnë propozime për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuesesinësferën e instrumenteve për mbrojtjen e minoriteteve ashtu edhe në atë të parandalimit të mbivotimit, të cilat janë qenësore apo të një rëndësie jashtëzakonisht

të madhe për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të serbëve të Kosovës.

ASI: Çfarë mendoni se mund të ofrojnë serbët e Kosovës për ta bërë Kosovën një shoqëri moderne evropiane?

Oliver Ivanoviq: Serbët janë minoritet në Kosovë. Si komunitet pakicë serbët nuk janë vetëm pjesë e problemit, por ata janë edhe pjesë e zgjidhjes. Kosova sot, më tepër se kurrë më parë, ka nevojë për stabilitet dhe siguri politike si dhe sundim të ligjit. Shqiptarët e Kosovës ende nuk e kuptojnë nevojën për një marrëveshje historike midis një komuniteti shumicë dhe një komuniteti pakicë. Ndërsa, serbët e Kosovës pikërisht këtu mund të luajnë një rol stabilizues dhe të ndihmojnë në krijimin e një klime të mirëbesimit të përgjithshëm. Kështu që, pres që shqiptarët ta kuptojnë përgjegjësinë e tyre si shumicë, posaçërisht kur është fjala për mbrojtjen e serbëve.

Synonim kthimin e dokumentacionit dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Kosovës

Astrit Haraqija, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Në muajin shtator të këtij viti, me bashkëpunëtorët e mi, pas ftesës që më ishte bërë kohë më parë, jam takuar në Beograd me homologun tim Kojadinoviq dhe mund të them se takimi është zhvilluar në një frymë fare konstruktive dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet dy vendeve fqinje.

Në opinionin publik dhe te mediat e të dyja vendeve ky takim ka zgjuar një interesim shumë të madh mbase për faktin se ishte takimi i parë i këtij niveli ndërmjet dy zyrtarëve të lartë që prej kohës së luftës në Kosovë. Gjithandej, duke e konsideruar të tillë takimi u përcoll me një interesim dhe publicitet të vecantë si në Kosovë e poashtu edhe në Serbi. Ndërkaq, për mënyrën se si u komentua në opinionin medial dhe ate publik nga të dyja anët takimi mendoj se nuk e vlen të diskutohet tashmë. Duhet thënë se te nivelet e ndryshme të politikës ndërkombëtare ky hap u vlerësua shumë lartë dhe kujtoj se mori një notë shumë të mirë. Kështu që, edhe me këtë rast është mirë ta themi se shkuarja në Beograd dhe takimi në nivel ministrash i ka kontribuar edhe bashkëpunimit dhe dialogut rajonal, faktor kyq për stabilitetin në rajon.

Nga ana tjetër, duhet thënë se takimi për asnjë moment nuk ka pasur karakter politik dhe nuk ka prejjudikuar asgjë sa i përket statusit politik të Kosovës, sepse fundja ne

aas qe e kishim këtë mandat të bisedonim në Beograd. Atëherë, cili ka qenë motivi për t'u realizuar ky takim dhe cfar është synuar gjatë mbajtjes së tij, shtrohet pyetja. Po, thjeshtë ishte një takim pune dhe ka qenë i fokusuar ekskluzivisht në çështjet që kanë të bëjnë me fushat e ndryshme të kulturës. Në kuadër të agjendës ishte paraparë gjithashtu të flitej edhe për procesin e rindërtimit të kishave serbe, proces ky i cili në kohën kur u mbajt takimi veq kishte filluar së realizuari. Kjo për faktin se unë në atë kohë isha edhe kryetar i Komisionit Ndërmintor për Rindërtim. Temë bosht pra e takimit ishin çështjet e kthimit të dokumentacionit dhe artefakteve të ndryshme të trashëgimisë kulturore të Kosovës, të cilat ishin marrë nga regjimi serb gjatë kohës së luftës, pastaj gjetja e mudësive për shkëmbim të përgjithshëm të aktiviteteve kulturore ndërmjet të dyja vendeve si dhe ideja për caktimin e koordinatorëve për kulturë nga të dy ministrat. Idenë e koordinatorëve e nxorëm për faktin se më lehtë dhe konkretisht do të realizoheshin veprimet në vazhdim për të gjitha ato që ishim marrë vesh në këtë takim, e që pastaj në këtë kuadër vetë ata, pra koordinatorët të merreshim me ngritjen e grupeve punuese-teknike me ekspertë nga lëmi të caktuara. Lidhur me këto çështje të dyja palët u dakorduam dhe krijohej përshtypja se edhe pala serbe

ishte e gatshme të përmbushte kërkesat tona për kthimin e të gjitha vlerave të rrëmbyera vite më parë në Kosovë. Ngeli që grupet punuese për kthimin e dokumentacionit, kthimin e artefakteve, çështjet që kanë të bëjnë me arkeologjinë, këmbimet kulturore dhe të tjera, të raportojnë dhe t'u përgjigjen ministrave përkatës për të gjitha çështjet e ngritura me këtë rast në nivel ministror.

U morëm vesh bashkërisht që UNMIK-utë jetë fasilikator për këtë process dhe që ai të kërkojë edhe bashkëpunimin e Këshillit të Europës, UNESCO-s dhe të gjitha institucioneve tjera kulturore ndërkombëtare sa herë që kjo do të ishte e nevojshme. Gjatë këtij takimi, unë në cilësinë e ministrit të MKRSCJ-së, e ftova homologun tim që takimin e ardhshëm ta mbanim në

Prishtinë, për cka u pajtua edhe ministri Kojadinoviq. Ç'është e vërteta, takimi i dytë nuk është realizuar ende, mirëpo unë pres dhe shpresoj se kjo do të ndodh sa më shpejt, sepse do të ishte në interes të të dyja vendeve dhe do ti shërbente klimës së bashkëpunimit fqinjësor e rajonal. Në rastin tonë pas gjithë asaj që ka ndodhur në të kaluarën do të krijonte, pervec tjerash, edhe një shtendosje marrëdhënesh me interes të gjërë.

Personalisht ndjehem mirë nëqoftëse me këtë takim kam arritur sadopak të ndikoj në tejkalimin e barrierave që na i vuri koha dhe fati historik Fundja, edhe atëherë por edhe sot mendoj se kisha plotësisht të drejtë ti kërkoja ato vlera të cilat u takojnë të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie.



Parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen e statusit të Kosovës



Nicholas Burns, Nënsekretar për çështje politike, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. Shtetet e Grupit të Kontaktit përfshijnë Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Rusinë, Gjermaninë, Francën dhe Italinë.

Kontakt Grupi e ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve dhe raportin e Kai Eides për vlerësimin gjithëpërfshirës të situatës në Kosovë, i cili është përfshirë në këtë letër, që i janë dorëzuar Këshillit të Sigurimit të KB-ve me 7 tetor 2005.

Grupi i Kontaktit mbështet rekomandimet e Sekretarit të Përgjithshëm për Këshillin e Sigurimit, të cilat janë bërë në bazë të këtij raporti, për të nisur procesin e përcaktimit të statusit

të ardhshëm të Kosovë në pajtim me Rezolutën 1244 të KS të KB-ve. Njëherësh, mirëpret edhe qëllimin e Sekretarit të Përgjithshëm që të emërojë një të Dërguar Special për ta drejtuar këtë proces. S'ka pikë dyshimi se Grupi i Kontaktit po ashtu do t'a mbështesë punën dhe të gjitha përpjekjet e të Dërguarit të Posaçëm dhe ekipit të tij.

Kështu që, gjetja e një zgjidhjeje të negociuar duhet të jetë prioritet ndërkombëtarë. Me të filluar procesi, ai nuk mund të

ndalet, por duhet të vazhdohet derisa të gjindet zgjidhja. Së këndejmi, Grupi i Kontaktit u bën thirrje të gjitha palëve që të angazhohen mirëfilli dhe në mënyrë konstruktive, që të përmbahen nga vendimet e njëanshme dhe të përjashtojnë çdo lloj dhune. Ata që do të përkrahin dhunën nuk do të kenë kurrëfarë roli. I Dërguari i Posaçëm mund të marrë masa adekuate brenda mandatit të tij të KB-ve për të suspenduar dhe përjashtuar çdo individ apo grup, nëse konstaton se

sjelljet dhe veprimet e tyre nuk shkojnë në favor dhe në interes të progresit.

Grupi i Kontaktit i fton të gjitha palët që të krijojnë ekipe të unifikuara për negociata, të cilat do të binin dakord rreth qëndrimeve të përbashkëta.

Procesi duhet të bëjë të sigurojë një pjesëmarrje efikase si për serbët e Kosovës ashtu edhe për qytetarët dhe komunitetet e tjera të Kosovës. Ndërkaq, pos kësaj, sipas nevojës duhet të konsultohen edhe fqinjët

në rajon dhe palët e tjera të interesuara.

Progresi në procesin e statusit do të varet jo vetëm nga niveli i angazhimit të palëve por edhe nga rrethanat në terren. Jetësimi i standardeve të formuluar (përcaktuara) nga Kombet e Bashkuara duhet të vazhdojë edhe përgjatë procesit të përcaktimit të statusit dhe do të jetë faktor mjaft me rëndësi për determinimin e progresit.

Grupi i Kontaktit rritet në rëndësinë që i kushton jo vetëm dialogut të qëndrueshëm dhe konstruktiv në të gjitha nivelet midis Beogradit dhe Prishtinës por edhe atij ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Njëherit, kërkon nga autoritetet në Beograd që aktivisht të angazhohen rreth inkurajimit të serbëve të Kosovës për të marrë pjesë në institucionet e Kosovës.

Këshilli i Sigurimit të KB-ve do të jetë akter dhe pjesëmarrës zyrtar në këtë çështje. Ndaj, vendimi përfundimtar për Statusin e Kosovës duhet të mbështetet nga Këshilli i Sigurimit të KB-ve.

Grupi i Kontaktit u bën të ditur të gjitha palëve të përfshira se rezultati i procesit të Statusit duhet të bazohet në parimet e përcaktuara si më poshtë:

1. Zgjidhja e çështjes së Kosovës duhet të jetë në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, demokracisë dhe ligjit ndërkombëtarë dhe t'i kontribuojë sigurisë rajonale.

2. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të jetë në përputhje me vlerat demokratike dhe standardet evropiane dhe duhet t'i kontribuojë realizimit të perspektivës evropiane të Kosovës, në veçanti, progresit të Kosovës në Procesin e Stabilizim-Asocimit si dhe integritet të gjithë rajonit në

institucionet euroatlantike

3. Zgjidhja duhet të sigurojë një multi-etnicitet të qëndrueshëm në Kosovë. Së këndejmi, duhet të sigurojë garanci efikase kushtetuese dhe mekanizma të përshtatshëm për t'a zbatuar parimin e respektimit të të drejtave njerëzore për të gjithë qytetarët e Kosovës si dhe të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve të Kosovës, përfshirë këtu të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.

4. Zgjidhja duhet të sigurojë mekanizma që do të garantojnë pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve të Kosovës në qeveri, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Ndërsa, strukturat efikase të vetëqeverisjes lokale, të krijuara përmes procesit të decentralizimit, duhet të ndihmojnë bashkëjetesën e komuniteteve të ndryshme dhe të sigurojnë qasje të barabartë dhe më të mirë në shërbimet publike.

5. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të përfshijë masa të veçanta mbrojtëse për trashëgiminë kulturore dhe religjioze në Kosovë. Këtu duhet të përfshihen edhe dispozita që e përcaktojnë statusin e institucioneve të Kishës Ortodokse serbe dhe lokaliteteve (objekteve) dhe pronave të tjera në Kosovë.

6. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet ta forcojë stabilitetin dhe sigurinë rajonale. Së këtejmi, kjo zgjidhje duhet të sigurojë që Kosova të mos kthehet në situatën para Marsit të vitit 1999. Njëherit, çdo zgjidhje që është e njëanshme ose që rezulton nga përdorimi i forcës do të jetë e papranueshme. Po kështu, nuk do të ketë ndryshim të territorit aktual të Kosovës, që do të thotë nuk do të ketë

ndarje të Kosovës apo bashkim të Kosovës me ndonjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti. Kështu që, integriteti territorial dhe stabiliteti i brendshëm i fqinjëve në rajon do të respektohet në tërësi.

7. Zgjidhja e statusit do të garantojë sigurinë në Kosovë. Njëherazi, do të sigurojë që Kosova nuk do të paraqesë kërcënim ushtarak apo të sigurisë për fqinjët e vet. Lidhur me masat (sistemin) e sigurisë do të përfshihen edhe dispozita të veçanta.

8. Zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të promovojë mekanizma efikasë për të forcuar kapacitetet e Kosovës për ta zbatuar sundimin e ligjit, për ta luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin dhe për ta ruajtur karakterin multi-etnik të policisë dhe gjyqësorit.

9. Zgjidhja duhet të sigurojë që Kosova mund të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme jo vetëm ekonomikisht por edhe politikisht dhe që të jetë në gjendje të bashkëpunojë në mënyrë efektive me organizata ndërkombëtare, në përgjithësi dhe me institucione ndërkombëtare financiare, në veçanti.

10. Kosova edhe për një kohë do të ketë nevojë për një prezencë ndërkombëtare civile dhe ushtarake me qëllim që të ushtrohet një mbikëqyrje adekuate e zbatimit të dispozitave për zgjidhjen e statusit, për të garantuar sigurinë dhe, në veçanti, mbrojtjen e minoriteteve si dhe për t'i monitoruar dhe mbështetur autoritetet në implementimin e vazhdueshëm të standardeve.



Takimi i 2687-të i Këshillit

Vendimi i Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme të Unionit Evropian për Kosovën

Bruksel, 7 nëntor 2005

Kryesuesi z. Xhek Strou, Sekretar Shtetëror për Çështje të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar

BALLKANI PERËNDIMOR
– Konkluzionet e Këshillit

Këshilli ka miratuar konkluzionet në vijim:

5. Këshilli ka mirëpritur Vlerësimin e Përgjithshëm të Kai Aides mbi gjendjen në Kosovë dhe ka shprehur përkrahjen e tij të plotë për qëllimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të filluar me procesin politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës.

6. Këshilli mirëpret emërimin nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KB të z. Marti Ahtisarit të Dërguar Special për bisedimet rreth statusit dhe z. Albert Rohan zëvendës të tij, dhe thekson mbështetjen e BE-së për misionin e tij dhe gadishmërinë për të punuar ngushtë me të.

7. Këshilli fton Prishtinën dhe Beogradin të angazhohen në mënyrë konstruktive dhe të besimit të mirë në procesin për definimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Të gjitha komunitetet në Kosovë, përfshirë edhe minoritetet, në veçanti sërbët duhet të luajnë rolin e tyre në këtë proces.

8. Këshilli ka vënë në theks rëndësinë e implementimit të standardeve tani dhe në të ardhmën. Dhe me rëndësi të veçantë është mbrojtja e minoriteteve. Këshilli shpreh mirënjohjen e tij për punën e z. Soren Jesen Petersenit, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

9. Duke cituar agjendën e BE-së në Selanik dhe Deklaratën e Këshillit të Europës për Kosovën të 17 qershorit 2005, Këshilli edhe njëherë konfirmon përcaktimin e Bashkësisë Europiane për të marrë pjesë në definimin e statusit të Kosovës dhe gadishmërinë për të qenë për së afërmi i involvuar në negociatën dhe implementimin e statusit të ardhshëm të saj. Në këtë kontekst, Këshilli gjithashtu konfirmon vullnetin për të bashkëpunuar me partnerët relevant dhe organizatat tjera ndërkombtare, përfshirë edhe OSBE-në e cila me prezencën e saj në Kosovë luan një rol tejet të rëndësishëm.

10. Këshilli mirëpret gadishmërinë e z. Marti Ahtisarit për të bashkëpunuar me BE-në. Këshilli mbështet emërimin e z. Stefan Lehne nga ana e Përfaqësuesit të Lartë të Sekretarit të Përgjithshëm, si përfaqësues të BE-së për procesin e definimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Nën udhëzimet e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshillit, përfaqësuesi i BE-së do të

mbështesë të Dërguarin e KB për Statusin në implementimin e mandatit të tillë dhe do t'i raportojë rregullisht Përfaqësuesit të Lartë të Sekretarit të Përgjithshëm dhe organeve përkatëse të Këshillit. Nën udhëzimet e Këshillit dhe në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, ai gjithashtu do të kontribuojë përgatitjeve për rolin e ri të BE-së në Kosovë.

11. Në prizmën e mundësisë së përfundimit të angazhimit të BE-së në Kosovë, Këshilli ka ftuar Përfaqësuesin e Lartë të Sekretarit të Përgjithshëm së bashku me Komisionin që të vazhdojnë bashkëpunimin në identifikimin e rolit të ardhshëm të BE-së dhe kontributit të mundshëm përfshirë këtu edhe lëminë e policisë, sundimit të ligjit dhe ekonomisë, dhe të t'i dorëzojnë Këshillit propozime të përbashkëta në një të ardhme të afërt.

12. Këshilli gjithashtu mirëpret bashkëpunimin e Komisionit me UNMIK-un dhe IPVQ për promovimin e avancimit në plotësimin e standardeve për Kosovën dhe prioritetet e identifikuar në Partneritetin Evropian me qëllim të zhvillimit të progresit drejt standardeve të BE-së.

13. Këshilli ka konfirmuar që Statusi i ardhshëm i Kosovës duhet të jetë në përputhje me vlerat dhe normat europiane, në harmoni me mekanizmat dhe obligimet ndërkombtare ligjore

si dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara. Zgjedhja e statusit duhet të ketë përsynim Kosovën, ku të gjithë pa dallim përkatësie etnike, do të jenë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë apo rrezik dhe ku gjithë qytetarët do të trajtoheshin të barabartë dhe të respektohen kulturat e ndryshme. Zgjedhja duhet të mbrojë të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për tu kthyer në vendet e tyre. Duhet të përfshijë masa të posaqme mbrojtëse për të ruajtur vendndodhjet religjioze dhe kulturore. Njëkohësisht marrëveshjet mbi statusin duhet të sigurojnë që Kosova të mos kthehet në situatën para marsit të vitit 1999. Çdo zgjedhje e njëanshme apo që ka rezultuar nga përdorimi i dhunës, apo ndryshim në kufinj të tanishëm të Kosovës do të jenë të papranuara. Nuk mund të ketë ndarje të Kosovës, as bashkim me vendet tjera apo me ndonjë pjesë të vendit tjetër. Integriteti territorial dhe stabiliteti i mbrendshëm i vendeve fqinje duhet respektuar plotësisht. Statusi i ardhshëm i Kosovës duhet të mundësojë Kosovës zhvillim ekonomik dhe politik të qëndrueshëm dhe të sigurojë që nuk do të paraqes ndonjë kërcënim ushtarak apo të sigurisë për fqinjët e saj. Zgjedhja e statusit të ardhshëm të Kosovës duhet të mundësojë Beogradin dhe Prishtinën progresin drejt Bashkimit Evropian.



Rezoluta e Kuvendit të Kosovës

Prishtinë, 17 nëntor 2005

Duke u mbështetur në Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, për të Drejtën e Popujve për Vetëvendosje dhe aktet e tjera ndërkombëtare;

Duke marrë parasysh aspiratën legjitime të popullit të Kosovës për të jetuar i lirë dhe në paqe me popujt tjerë;

Duke u mbështetur në zhvillimet historike, juridike e kushtetuese të Kosovës, të shprehur në Konferencën e Bunjajt (1943-44), në Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990, në Referendumin e vitit 1991, si dhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran të vitit 1991;

Duke u bazuar në luftën e gjatë të popullit të Kosovës për liri e pavarësi;

Duke u bazuar në rezistencën e përgjithshme ndaj okupimit dhe në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

Duke konfirmuar garantimin për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë sipas standardeve ndërkombëtare;

Duke u bazuar në programet e partive politike për statusin politik të Kosovës;

Duke e çmuar lart intervenimin e NATO-s në Kosovë për të ndalë gjenocidin dhe pastrimin etnik në Kosovë nga ana e Serbisë, si dhe ndihmën ndërkombëtare dhënë në Kosovës;



Kuvendi i Kosovës nxjerrë këtë:

REZOLUTË

për rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës

Për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran

1. Kuvendi i Kosovës rikonfirmon vullnetin e popullit të Kosovës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran;

2. Kuvendi i Kosovës garanton rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për Pavarësi nëpërmjet Referendumit;

3. Kuvendi i Kosovës merr obligim të nxjerrë Kushtetutën e Kosovës në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian;

4. Kuvendi i Kosovës kërkon përkrahjen ndërkombëtare për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran, nga Organizata e

Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, si dhe nga vendet e tjera;

5. Kuvendi i Kosovës shpreh gatishmërinë që t'i ratifikojë të gjitha konventat dhe aktet e njohura ndërkombëtare, mbi të drejtat e njeriut dhe mbi të drejtat e komuniteteve, që dalin prej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian;

6. Kuvendi i Kosovës zotohet për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut për qytetarët e Kosovës dhe të drejtave të komuniteteve minoritare në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare;

7. Kuvendi i Kosovës angazhohet që Kosova të integrohet në strukturat Evropo-Atlantike, mirëprehet angazhimin e tyre të mëtejme në Kosovë,

dhe angazhohet për raporte të mira me vendet fqinje duke kontribuar për stabilitetin e rajonit;

8. Kuvendi i Kosovës garanton tërësinë territoriale të Kosovës dhe pacenueshmërinë e kufijve të saj;

9. Kuvendi i Kosovës konfirmon se vullneti i popullit të Kosovës për Pavarësi është i panegocueshëm;

10. Kuvendi i Kosovës duke e mbështetur Delegacionin e Kosovës, do të përcjellë gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim për të ardhmen e Kosovës do të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet Referendumit;

Kjo Rezolutë paraqet bazën juridike dhe politike për platformën e Delegacionit të Kosovës për pavarësinë e Kosovës.

Dokumenti i Delegacionit të Kosovës për Marti Ahtisarin, Emisarin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për statusin final të Kosovës

Hyrje

1. Ky dokument përbën një përmbledhje të shkurtër të qëndrimeve të Delegacionit të Kosovës si për procesin ashtu edhe për rezultatin e procesit për përcaktimin e statusit final të Kosovës, që filloi me Deklaratën Presidenciale të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 24 tetor 2005. Qëndrimet e Delegacionit të Kosovës mbështeten në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran, të miratuar më 17 nëntor, 2005.

Procesi

2. Delegacioni i Kosovës mirëpret procesin e zgjidhjes së statusit final të Kosovës. Ai zotohet që të luajë një rol konstruktiv në këtë proces dhe të jetë i hapur për biseda me të gjitha palët, dhe në veçanti me të Dërguarin Special të KB-së, dhe Grupin e Kontaktit, duke përfshirë këtu edhe Emisarin special

të SHBA-së dhe Bashkimit Evropian. Delegacioni i Kosovës është i gatshëm të bisedojë rreth të gjitha çështjeve relevante haptas dhe në mënyrë konstruktive. Në zotohemi për një proces paqësor, gjithëpërfshirës i cili do të adresojë të gjitha problemet ekzistuese të Kosovës në këtë proces, dhe refuzojmë pa kusht të gjithë ata që promovojnë dhunën për qëllime politike ose për qëllime të tjera.

2.1 Delegacioni i Kosovës do të mirëpret angazhimin aktiv dhe afirmativ të përfaqësuesve të të gjitha komuniteteve minoritare në këtë proces përmes një bashkëpunimi intensiv me Delegacionin e Kosovës.

Në këtë kontekst, Delegacioni i Kosovës ka propozuar formimin e Këshillit konsultativ të komuniteteve pakicë.

2.2. Delegacioni i Kosovës beson fuqimisht që procesi i zgjidhjes së statusit të

Kosovës duhet të jetë i hapur dhe transparent për popullin e Kosovës dhe për opinionin ndërkombëtar. Pas viteve të statusit të përkohshëm dhe të institucioneve të përkohshme, edhe Kosovës edhe rajonit i nevojitet qartësia a plotë e statusit të Kosovës

Orari

3. Delegacioni i Kosovës beson se ky proces duhet të ketë një kornizë të qartë kohore. I Dërguari Special i OKB-së Këshilli i Sigurimit i KB-së dhe Grupi i Kontaktit do të duhej të siguronin që procesi të përmbyllet, më së voni, nga mesi i vitit 2006. Këtë orar do ta respektojnë në mënyrë të plotë Delegacioni i Kosovës.

Statusi final: Shteti i Kosovës

4. Vullneti i fuqishëm i popullit të Kosovës është që Kosova përfundimisht të njihet si shtet i pavarur dhe sovran, në kufijtë e saj të njohur. Kufijtë e shtetit të Kosovës nuk mund të ndryshohen në asnjë mënyrë. Qeveria a Kosovës duhet të jetë sovranë në të gjithë territorin e Kosovës.

4.1. Shteti i ardhshëm demokratik i Kosovës do të jetë shtet ligjor në të cilin kanë qasje të gjithë qytetarët a saj. Të gjithë qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të barabartë të jetojnë në paqe dhe siguri dhe t'u respektohen të drejtat e tyre individuale dhe politike.

Kushtetuta e ardhshme e Kosovës dhe strukturat e qeverisë do t'u sigurojnë të gjithë qytetarëve të Kosovës mbrojtje të plotë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

Shteti i Kosovës garanton ndërtimin e mëtejshëm dhe funksionimin e institucioneve demokratike.

4.2. Delegacioni i Kosovës zotohet për organizimin e tillë të qeverisjes ashtuqë të gjitha komunitetet e Kosovës të kenë pjesëmarrje të drejtë në qeveri, si në atë nivelin lokal ashtu edhe qëndror.

Delegacioni i Kosovës është i vetëdijshëm për rëndësinë që ka decentralizimi në sigurimin e kësaj të drejte.

Delegacioni i Kosovës dhe institucionet e Kosovës do të hartojnë kornizën e duhur ligjore për reformën e pushtetit lokal.

Kosova do të krijojë struktura efikase demokratike të vetëqeverisjes lokale në shërbim të lehtësimit të bashkëjetesës dhe të komuniteteve të ndryshme për të siguruar qasjen e drejtë në shërbimet publike.

4.3. Kosova do të jetë një shtet laik që respekton besimet, gjuhët dhe traditat kulturore të të gjithë qytetarëve të saj. Në veçanti, ajo do të sigurojë mbrojtjen e plotë ligjore të trashëgimisë religjioze dhe kulturore.



Delegacioni i Kosovës zotohet që ky të jetë njëri prej elementeve përbërës të Marrëveshjes për statusin e Kosovës.

4.4. Kushtetuta e shtetit të Kosovës do të inkorporojë ligjet relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe të grave, përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Deklaratën e OKB-së mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave.

4.5. Kosova garanton të drejtën e të gjithë personave të zhvendosur dhe të refugjatëve që të kthehen në pronat, shtëpitë, banesat a tyre me të gjitha të drejtat si qytetarë të Kosovës.

4.6. Delegacioni i Kosovës dhe institucionet e Kosovës do të garantojnë të drejtat e komuniteteve pakicës sipas standardeve ndërkombëtare. Këto të drejta do të garantohen me Kushtetutë dhe me ligjet përkatëse.

4.7. Kosova do të vazhdojë përkushtimin e saj për zbatimin e standardeve në sundimin e ligjit, për mbrojtjen e pakicave dhe për funksionalitetin e institucioneve, etj., për aq sa nevojitet që ato standarde plotësisht të mishërohen në jetën e institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës.

4.8. Mbi baza të së drejtës ndërkombëtare dhe mbi baza të vlerave universale

demokratike, Kosova do të garantojë qarkullimin e lirë të njerëzve, të mallrave, ideve dhe informacionit, si dhe do të ofrojë kontributin e vet në luftë kundër terrorizmit dhe dukurive tjera negative që e rrezikojnë sistemin e drejtësisë ndërkombëtare, stabilitetin rajonal, shoqërinë, njeriun dhe vlerat e tij. Kosova do të bashkëpunojë plotësisht me Interpolin dhe Evropolin, dhe organizatat e ngjashme ndërkombëtare.

Ekonomia e Kosovës

5. Zhvillimi ekonomik është penguar nga paqartësia e statusit të Kosovës dhe nga kontestimet që përkrijnë me procesin e ndarjes së pronës shtetërore të ish-Jugosllavisë dhe të bizneseve në Kosovë.

Delegacioni i Kosovës pret që gjatë negociatave të zgjidhen çështjet kontestuese nga shpërbërja e ish-RSFJ-së dhe lufta në Kosovë e viteve 1998, 1999. Populli i Kosovës ka të drejtë në këtë pronë, dhe qeveria demokratike duhet ta organizojë këtë në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë. Ne zotohemi në sigurimin e arbitrimin të drejtë dhe në mbrojtjen e të drejtave pronësore. Ne synojmë një strukturë të hapur dhe lehtë të rregulluar ekonomike për Kosovën, në mënyrë që të sigurojmë një zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm. Duke pasur parasysh afërsinë tanë me fqinjët dhe ndërvarshmërinë e ekonomive tona, Kosova do të synojë kufij të hapur dhe tregti të lirë brenda rajonit.

Marrëdhëniet rajonale të Kosovës

6. Kosova zotohet të ketë marrëdhënie paqësore dhe të hapura me të gjithë fqinjët. Kosova nuk ka pretendime territoriale përtej kufijve të saj dhe as që do të merret me kurrfarë pretendimi ndaj territorit të saj. Një Kosovë e pavarur do t'u përkushtohet plotësisht ligjeve ndërkombëtare dhe parimeve të Kartës së OKB-së.

6.1 Pas pavarësisë, Kosova pret zhvillimin e raporteve më të ngushta me të gjithë

fqinjët. Kosova do të mirëpret dhe nxitë bashkëpunimin ekonomik rajonal dhe promovimin e tregtisë së lirë dhe të zhvillimit ekonomik në rajonin e Evropës Juglindore.

Marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës

7. Shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës aspiron anëtarësi të plotë në Kombet e Bashkuara dhe në institucionet e tjera relevante ndërkombëtare, si në Fondin Ndërkombëtar Monetar, Bankën Botërore dhe në Organizatën Botërore të Tregtisë.

7.1. Kosova mirëpret një integrim të shpejtë me strukturat Euro-Atlantike. Në veçanti, ajo mbetet plotësisht e përkushtuar në kërkimin e statusit të Stabilizim-Asociimit dhe përfundimisht edhe anëtarësisë në Bashkimin Evropian. Në fushën e sigurisë, shteti i Kosovës do të kërkojë partneritet me NATO-n dhe përfundimisht anëtarësi në të.

7.2. Kosova e pavarur mirëpret angazhimin e ngushtë të edhe BE dhe NATO-s, pastaj të OSBE, Këshillit të Evropës dhe të tjerëve, në garantimin e sigurisë të shtetit dhe për rendin e ligjin për të gjithë qytetarët e saj.

7.3. Delegacioni i Kosovës fton të gjitha institucionet relevante, si NATO-n dhe

BE-në, që me praninë e tyre në Kosovën e pavarur, pas zgjidhjes së statusit final, të kontribuojnë në forcimin e mëtejshëm të institucioneve të Kosovës. Delegacioni i Kosovës përsëritet një prani të tillë si kontribut për stabilitetin e Kosovës dhe në procesin e ndërtimit institucional të saj.

7.4. Kosova shtet i pavarur dhe sovran do të ketë forcën mbrojtëse e cila në bashkëpunim me NATO-n do të garantojë sigurinë e kufijve dhe qytetarëve të saj dhe do të kontribuojnë edhe për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit.

Përfundimi

8. Delegacioni i Kosovës vlerëson se ky dokument shpreh bazën e pozicionit

të Kosovës tonë mbi çështjet kyçe, dhe në veçanti dëshirën tonë për krijimin e një shteti demokratik, ligjor dhe paqëndashës të Kosovës. Shteti i pavarur dhe sovran i Kosovës do të qetësojë popullin e Kosovës, do të krijoj stabilitet në Kosovë dhe do të garantojë siguri afatgjatë në këtë pjesë të Evropës dhe të Botës.

*Prishtinë, 22 Nëntor, 2005
Delegacioni i Kosovës*

Negociatat kundër vetëvendosjes

Albin Kurti, anëtar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!



Vetëvendosja është liria kolektive pa të cilën s'mund të ketë liri individuale. Vetëvendosja nuk është vetëm liria për të zgjedhur për fatin tonë por dhe liria për t'u zhvilluar. Ndonëse realizimi i saj nuk është garancion për përparim, sigurisht se është parakusht për të. Aktualisht ne jemi të privuar nga shansi dhe mundësia për përparim. Trendet politike, sociale dhe ekonomike janë përgjithësisht negative. Jemi sorollatur pas 'standardeve para statusit' ndërkohë që standardi i jetesës së qytetarit veç sa ka degraduar. Asgjë e çuditshme:

kur s'ke liri, ngadalë por sigurt, mbetesh edhe pa bukë. Shumë më e rëndësishme është që njerëzit të kenë vend pune dhe ushqim të bollshëm sesa të kenë të drejtë vote. Aq më tepër që kur voton në Kosovë më parë dhe më tepër legjitimon sistemin politik sesa që zgjedh gjë. Kuvendi i Kosovës është kurthuar në betejën e partive politike që nuk janë kauza por aranzhmane, që kanë liderë të fortë sepse janë të dobëta, që s'kanë as vizion e as ideologji, dhe që kryesisht përbëhen prej njerëzve etja për privilegje dhe luks e të cilëve është neurozë

narcistike. Këta politikanë, deputetë e ministra, thonë se gjithsesi do të ketë pavarësi, ngaqë s'kanë kurrfarë strategjie për variantet tjera që po na përgatiten e ku këta kanë hyrë. Një pjesë e mirë e popullit disi u beson këtyre, sepse nuk do që ta besojë poshtërimin dhe fyerjen që po i bëhet. Pluralizmi politik pa shtet tëndin nuk u tregua as konstruktiv e as produktiv. Ai veç sa krijoi iluzionin e normalitetit. Zaten, edhe Milosheviqi i lejonte partitë politike.

Ende s'e kemi as qeverinë që

e meritojmë. Sepse, ende se kemi llojin e qeverisjes që na takon. Politikanët e Kosovës në fakt i përgjigjen UNMIK-ut, ndërsa UNMIK-u i përgjigjet New York-ut. Edhe serbët e Kosovës janë në pozitë të palakmueshme: liderët e tyre i përgjigjen Beogradit. UNMIK-u s'është demokratik në vetvete: është piramidë autoritare politike ku urdhrat vijnë nga lart poshtë dhe pa kurrfarë demokracie të brendshme në vendimmarrje. UNMIK-u s'është demokratik në Kosovë: çdo gjë vendore i është subordinuar UNMIK-ut dhe ky subordinim është

kodifikuar dhe normuar me Rezolutën 1244 dhe Kornizën Kushtetuese. Në emër të ndërtimit të demokracisë sundohemi në mënyrë jodemokratike. Dhe, evitohet fakti se pikërisht vetëvendosja është akti inauguroes dhe themeltar i demokracisë. I çfarëdo demokracie. I secilit lloj të saj.

Në anën tjetër, vetëvendosja i afirmon qytetarët si burim sovraniteti. Edhe kjo në Kosovë mungon. Paralelisht, vetëvendosja është parimi i procesit të papërfunduar të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, parim ky që padrejtësisht iu mohua Kosovës. Pa vetëvendosje për Kosovën, s'mund të shpallet i dështuar projekti i Milosheviqit dhe s'mund të fillojë procesi i denazifikimit dhe i demokratizimit të vërtetë të Serbisë. Realizimi i vetëvendosjes është minimumi i kompensimit moral për padrejtësinë shekullore dhe humbjet e dëmet që na janë shkaktuar.

Rrjedhimisht, vetëvendosja për Kosovën duhet të jetë e dyfishtë: vetëvendosje e jashtme në raport me Unionin SMZ dhe vetëvendosje e brendshme në raport me UNMIK-un.

Kosova, tash për tash, s'është e mundur të jetë e përfaqësuar. Fundja, edhe më e rëndësishme është: në çka e për çka është përfaqësimi? I gjithë investimi aktual është që të jemi sa më të përfaqësuar NË negociata me Serbinë. I gjithë investimi aktual është që të jemi sa më të përfaqësuar PËR kompromis. Politikanët e Kosovës thonë se s'do të ketë

Vetëvendosja është liria kolektive pa të cilën s'mund të ketë liri individuale. Vetëvendosja nuk është vetëm liria për të zgjedhur për fatin tonë por dhe liria për t'u zhvilluar. Ndonëse realizimi i saj nuk është garancion për përparim, sigurisht se është parakusht për të. Aktualisht ne jemi të privuar nga shansi dhe mundësia për përparim. Trendet politike, sociale dhe ekonomike janë përgjithësisht negative. Jemi sorollatur pas 'standardeve para statusit' ndërkohë që standardi i jetesës së qytetarit veç sa ka degraduar. Asgjë e çuditshme: kur s'ke liri, ngadalë por sigurt, mbetesh edhe pa bukë.

negociata me Serbinë por me bashkësinë ndërkombëtare dhe se ato nuk do të jenë për statusin e Kosovës. Flasin për këto dy gjëra andaj gënjëjnë vetëm dyfish.

Negociatat janë negociata me Serbinë për Kosovën. Ato janë koncept dhe projekt politik në kundërshtim të plotë me vetëvendosjen e popullit të Kosovës. Procesi negociues që po përgatitet është shpërfillje e vullnetit të popullit, është përbuzje dhe denigrim i tij.

Negociatat kanë kuptim vetëm kur zhvillohen ndërmjet palëve të barabarta. Kosova nuk është shtet sikur Serbia, dhe nuk ka qeveri reale sikur Serbia, por ka një qeveri fiktive. Qeveria e Kosovës është e privuar nga përmbajtja e vërtetë në mënyrë të dyfishtë: nuk i ka ministrinë esenciale (të mbrojtjes, punëve të brendshme dhe të jashtme, drejtësisë, informatave) dhe secila ministri ekzistuese s'ka kompetenca të plota (p.sh. Et'hem Çeku, ministri i energjetikës, nuk e kontrollon aspak as KEK-un dhe as Trepçën të cilat janë ndërmarrje shoqërore e publike në duart e AKM-së). Nuk mund të negociojë Kosova me Serbinë sepse

s'janë zhbërë strukturat e Serbisë në Kosovë. Kosova pra përveçse me UNMIK-un mbi kokë e ka edhe Serbinë në qafë. Këto negociata ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk po parashihen edhe për Kosovën edhe për Serbinë, por vetëm për Kosovën. Me Serbinë u dashka të negociojmë për vendin tonë, shtëpinë tonë, lirinë tonë! Kosovës realisht nuk i mungon statusi por popullit të saj i mungon liria. E i burgosuri nuk negocion. Negociatat gjithsesi shpiejnë në kompromis sepse e nënkuptojnë gatishmërinë për të.

Serbia jo vetëm që s'u pendua për krimet që kreu por kurrfarë drejtësie për viktimat nuk u zbatua. Për më tepër, Serbia do që sërish ta rimarrë Kosovën, mirëpo duke e copëtuar atë paraprakisht nëpërmjet decentralizimit. Serbia, madje në rastin më të mirë, po na e ofron atë që na e pat marrur: autonominë! E vetmja Serbi me të cilën mund të negociohet është ajo e cila e pranon vetëvendosjen për Kosovën. Me Serbinë sigurisht se kemi shumëçka të negociojmë, por vetëm atëherë kur të jemi të lirë dhe të bëhemi të barabartë.

Vetëm vetëvendosja siguron kushtet për marrëdhënie të mira ndërmjet shqiptarëve

dhe serbëve në Kosovë. 80% të të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi në vitet e '80-ta ishin shqiptarë sepse populli shqiptar kishte më së paku liri nga të gjithë popujt e tjerë në Jugosllavi dhe sepse Kosova nuk ishte republikë sikurse njësitë e tjera që më pas u bënë shtete. Përkundër kësaj, marrëdhëniet shqiptaro-serbe arritën kulmin e vet pozitiv pas autonomisë së brishtë të vitit 1974 ngase atëherë Kosova ishte më së largu nga kontrolli i Beogradit. Dhe, marrëdhëniet shënuan degradimin më të madh gjatë kohës së Milosheviqit, kur Kosova jo vetëm se ishte tërësisht nën sundimin e forcave të tij por edhe terrorizohej prej tyre. Marrëdhëniet më të mira, e të papara deri më tash, do të jenë pikërisht kur të realizohet vetëvendosja e jashtme. Marrëdhëniet shqiptaro-serbe në Kosovë maten me distancën e Kosovës prej Beogradit.

Lëvizja VETËVENDOSJE! fillimisht ka për synim që totalizimin e regjimit të UNMIK-ut ta zëvendësojë me polarizim. Një ndarje e re, jo nëpër parti politike, por në regjim të padrejtë në njërin anë dhe në popull që kërkon të drejta e drejtësi, liri e barazi, në anën tjetër, po ndërtohet. Kjo ndarje e re është e domosdoshme për dialektikë të vërtetë, për problematizim të duhur ngase fundamental. Edhe neve, sikurse çdo populli, na duhen toka dhe buka. E për këto, na duhet vetëvendosja, na duhet realizimi i vetes.

Prishtinë, 15 nëntor 2005

Zhvillimet e fundit në Kuvend

Franklin De Vrieze, *Misioni i OSBE-së në Kosovë*

Kuvendi miraton rezolutën për të rikonfirmuar vullnetit e popullit

Me 17 nëntor 2005, Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë për të rikonfirmuar vullnetin e popullit për një shtet të pavarur dhe sovran, e cila do të shërbejë si platformë legale dhe politike për delegacionin e Kosovës në negociatat për statusin.

Me 29 shtator, PDK-ja si partia opozitare fillimisht pati dorëzuar një projekt rezolutë. Propozimi iu referua grupit punues shumëpartiak, i cili ishte ngarkuar për ta përgatitur propozimin (versionin) përfundimtar, që do të ishte i pranueshëm për të gjitha partitë politike. Ndërsa, Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, nga njëra anë dhe kryetari i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet në UE, nga ana tjetër dolën secili me nga një draft. Së këndejmi, sfida më e madhe si e udhëheqësve të grupeve parlamentare ashtu edhe e kryetarëve të dy komisioneve ishte dakordimi rreth një drafti, duke i mbajtur parasysh parimet udhëzuese të Grupit të Kontaktit ku përjashtohet mundësia për hapa të njëanshëm gjatë procesit të përcaktimit të statusit final. Me këtë rast, duke e përcjellur porosinë e Grupit të Kontaktit, PSSP-ja dhe shefi i Zyrës amerikane intervenuan me qëllim që të evitonin një konflikt të mundshëm midis IPVQ-ve dhe Bashkësisë Ndërkombëtare pikërisht para fillimit të negociatave. Kështu që, pas ca konsultimesh midis grupeve parlamentare lidhur me ndryshimet që duhej të përfshiheshin, e të cilat zgjatën disa orë, në sesionin plenar u mbështet versioni përfundimtar i tekstit të rezolutës, i cili do të shërbejë si platformë për delegacionin nga Kosova për ta adresuar çështjen e statusit, dhe njëherit si i tillë teksti i rezolutës nuk u kundërshtua nga UNMIK-u (Tekstin e plotë të rezolutës mund ta gjeni në këtë edicion)

Kuvendi miraton nismën për hartimin e kushtetutës së re

Me 21 tetor 2005, grupi parlamentar i AAK-ës i dorëzoi Kryesisë së Kuvendit propozimin për hartimin e një kushtetute të re. Me këtë rast, AAK-ja ka kërkuar që grupi punues, që do të jetë përgjegjës për hartimin e kushtetutës, të ketë në përbërjen e tij udhëheqësit e grupeve parlamentare; Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizës Kushtetuese; dhe, Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Ky propozim u diskutua gjërisht në sesion plenar të 17/21 nëntorit, me ç'rast LDK-ja doli me propozimin që të themelohet një Komision i ri për hartimin e kushtetutës. Në fund, u arrit marrëveshja që të votohet rreth nismës për hartimin e kushtetutës, në mënyrë që Kryesia e Kuvendit më pas të dakrodohet me udhëheqësit e grupeve parlamentare lidhur me përbërjen e këtij grupi punues. Propozimi u miratua njëzërit.

Shtyhet formimi i Komisionit të Kuvendit për Siguri

Me 10 tetor, Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë i parashtrori Kryesisë një kërkesë për të "përshpejtuar procedurën



rreth krijimit të një komisioni parlamentar që do të merrej me sigurinë dhe njëherit për të sqaruar nëse Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë duhet të vazhdojë të ekzistojë." Në sesionin plenar të 17/21 nëntorit ishte e qartë se grupet parlamentare kishin pikëpamje të ndryshme. Çështja ishte se a duhet të formohet një Komision i ri për Siguri apo mbase Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë duhet të jetë përgjegjës për çështjet e sigurisë. Së këtejmi, kryesuesi i sesionit vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet derisa të arrihet një marrëveshje midis Kryesisë dhe grupeve parlamentare.

Me 10 nëntor me ndihmën dhe iniciativën e PSSP-së u mbajt mbledhja e parë e Grupit Konsultativ për Rishikimin e Sigurisë së Brendshme (ISSR/CG). Me këtë rast, afro 50 përfaqësues të IPVQ-ve, bashkësisë ndërkombëtare, partive politike, komuniteteve, shoqërisë civile, dhe grupeve të tjera të interesit u takuan për t'i shkëmbyer pikëpamjet dhe mendimet e tyre rreth çështjeve të sigurisë.

Me 18 nëntor, nisi nga puna programi i zhvillimit profesional për mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë. Në tyezën e parë morrën pjesë 28 pjesëmarrës, përfshirë këtu 16 deputetë të Kuvendit. Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura (DCAF) me seli në Gjenevë ndihmoi mbajtjen e këtij sesioni dhe me këtë rast kishte ftuar tre mysafirë: deputetë të Parlamentit të Sllovenisë dhe Rumunisë si dhe Komisionerin për Mbikëqyrje të Reformës Policore nga Irlanda Veriore. Ndërkaq, Misioni i OSBE-së në Kosovë siguroi materiale dhe dokumente që kanë të bëjnë me legjislacionin bashkëkohor të reformës në sektorin e policisë në Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi dhe Shqipëri.

Kuvendi vazhdon punën rreth themelimit të KPM-së dhe miratoi disa projektligje

Në seancën e 17-21 nëntorit, Kuvendi miratoi propozimin për themelimin e një komisioni parlamentar ad-hoc për t'i rekomanduar Kuvendit emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Përkohshëm të Mediave. Veç kësaj, Kuvendi pas leximit të parë miratoi draftligjin për Ushqim, ndërsa pas leximit të dytë miratoi ligjet për Investime të Huaja, Dizajnit Industrial, dhe Akreditimit.

Përfundon programi për mbështetje ligjore për Kuvendin

Projekt i OSBE-së për mbështetjen e Departamentit për Çështje Ligjore të Kuvendit të Kosovës përfundoi në fund të tetorit 2005. Projekti, që u implementua nga Institut International de Paris La Defense, ofroi jo vetëm ekspertizë ligjore por edhe ngritjen e kapaciteteve për përkthime ligjore të Kuvendit të Kosovës, pas ndërprerjes së përkohshme të projektit të AER-it.

Programi u ka ndihmuar disa komisioneve për hartimin e planeve të punës dhe e ka mbështetur krijimin e nënkomisioneve të specializuara. Kjo nismë ka kontribuar për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit të komisioneve relevante me Bashkësinë Ndërkombëtare lidhur me transferin e kompetencave në gjyqësi dhe siguri, duke organizuar ca konsultime me Shtyllën e I-rë dhe me Zyrën për Çështje Ligjore të UNMIK-ut.

Veç kësaj, ky projekt bëri të mundur hartimin draft ligjit për statusin e personelit të Kuvendit, draft rregullores mbi organizimin e Sekretariatit të Kuvendit dhe draft statutit të Sekretariatit të Kuvendit.

Pakti i Stabiliteti do të adresojë pronësinë mbi proceset rajonale

Tryeza Rajonale e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore (EJL) dhe takimet e Tryezës së Punës që fokusohen në tema të caktuara u takuan me 15 dhe 16 nëntor në Pragë për t'i diskutuar çështjet e pronësisë ndaj proceseve rajonale. Me këtë rast, afro 200 pjesëmarrës që përfaqësonin 80 shtete dhe organizata debatuan për sfidat dhe bashkëpunimin rajonal në EJL. Në këtë ngjarje morrën pjesë edhe pjesëmarrës nga IPVQ-ët. Tema kryesore e bisedimeve në Tryezën e I-rë (Demokracia), ishte bashkëpunimi parlamentar rajonal. Me këtë rast, rëndësia e parlamenteve të EJL për perspektivën e përbashkët për anëtarësim në EU është cilësuar si burim kryesor për zhvillimin e një bashkëpunimi më kuptimplotë rajonal. Parlamentarë nga



gjashtë parlamente të EJL arritën një koncesus rreth nevojës për ndërtimin e kapaciteteve në të ardhmen, duke i dhënë prioritet çështjes së mbikëqyrjes efikase parlamentare në fushën e zbatimit të legjislacionit, avansimit dhe fuqizimit të punës së komisioneve që merren me integrimet euroatlantike, kontrollit demokratik të sektorit të sigurisë, kontrollit të buxhetit dhe reformës së gjyqësorit.



“Grupi për Strategji Politike”, nga ana e majtë Jakup Krasniqi, Ylber Hysa, Skender Hyseni, Blerim Shala, Kolë Berisha, Ardian Gjini.

Delegacioni i Kosovës përgatit platformën dhe strategjinë e bisedimeve për status

Pas mbledhjes së parë të mbajtur me 6 tetor 2005, Delegacioni i Kosovës për Bisedime për Status mbajti disa mbledhje me qëllim që të përgatisë platformën dhe strategjinë e tij për bisedimet rreth statusit. Anëtarët e këtij delegacioni janë Presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, Kryetari i Kuvendit të Kosovës Nexhat Daci, Kryeministri i Kosovës Bajram Kosumi, liderët e opozitës Hashim Thaçi nga PDK-ja, Veton Surroi nga ORA, dhe Blerim Shala, koordinator i grupit të punës. Veç tjerash, në këtë mbledhje delegacioni themeloi edhe “Grupin për Strategji Politike” që përbëhet nga nënkryetarët e katër partive kryesore të shqiptarëve të Kosovës – Kolë Berisha (LDK), Jakup Krasniqi (PDK), Ardian Gjini (AAK), and Ylber Hysa (ORA)— tok me Blerim Shalën. Grupi për Strategji Politike ishte autorizuar që të fillojë me “hartimin e platformës politike për shtetin e pavaruar dhe sovran të Kosovës bazuar në propozimet e bëra gjerë më tani.” Mbledhja e pestë e Delegacionit të Kosovës u mbajt me 18 nëntor pas së cilës Zyra e Presidentit lëshoi një deklaratë ku bëhej e ditur se është themeluar një “Këshill Konsultativ” për çështje të komuniteteve pakicë, i cili do ta këshillojë Ekipin rreth çështjeve të minoriteteve. Po kështu, u miratua edhe propozimi për themelimin e “grupeve të ekspertëve”. Njëherit, Delegacioni i Kosovës u takua me 21 nëntor për të miratuar platformën për statusin e Kosovës, që do t'i prezantohet të Dërguarit Special Martti Ahtisaari me 22 nëntor.

(Teksti i plotë i platformës është përfshirë në këtë edicion)

Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respektimin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legjislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-it Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregulltë i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje Perëndim (EWPPP), Agjensioni Europian për Rindërtim (EAR), Agjensioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Instituti Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Ramush Tahiri, Franklin De Vrieze, Blerim Vela, Labinot Hoxha, Edmond Efendija, Krenar Loshi.

**Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>**

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotot në këtë buletin: Gazeta Ditore Ekspres: fq. 1, 12 (Ferdi Limani) / fq. 3 (Flaka Kuqi) / fq. 4, 13, 14, 20, 23 (Astrit Ibrahim) / fq. 5, 8, 11 (Fisnik Dobreci) / fq. 15, 18 (Ernal Meta) / fq. 24 (Atdhe Mulla) / OSBE: fq. 2, 6, 7, 10, 17, 22.